



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja X / 2023 e rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 28.12.2023, duke filluar nga ora 10:00, në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Në fillim të mbledhjes ishin të pranishëm 31 anëtarë të Kuvendit, u bashkëngjitën gjatë mbledhjes edhe të tjerë.

Të pranishëm në mbledhje ishin ekzekutivi komunal, kryetari i Komunës, nënkryetari dhe drejtorët e drejtorive komunale.

Po ashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, OSBE-ja, dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përhëndeti të gjithë të pranishmit. Fillimisht, kryetari kërkoi fjalën.

Shaqir Totaj (Kryetar i Komunës): Faleminderit! Para se të fillojmë seancën e sotme, unë desha të ju përhëndes krejtve. Ju falënderoj për punën, për angazhimin që e keni pas gjatë këtij viti. Konsideroj që Asambleja Komunale e Prizrenit ka performuar mirë, ka pasur një qasje pozitive, një frymë të bashkëpunimit, pa marrë parasysh kritikën që janë pjesë e punës edhe që janë të mira. Deshta me ju falënderu për këtë punë, për këtë angazhim, për energjinë e deponuar. Edhe njëkohësisht, uroj që vitin e ardhshëm, gjithë së bashku, pa dallime partiake, në këtë rast, të mbajmë këtë qasjen pozitive, proaktive, edhe të kontribuojmë për një qëllim të përbashkët, i cili është kontributi për ngritjen e cilësisë dhe kualitetit të jetës në territorin e komunës së Prizrenit. Edhe njëkohësisht, uroj vitin e ri, edhe pse është hala herët, se kemi 2-3 ditë. Qekaq pata. Faleminderit!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit kryetar! Konstatoj që prezent jemi 31 anëtarë të kuvendit. Atëherë sipas rekomandimit të komitetit për politikë dhe financa është propozuar ky rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 23 nëntor 2023;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-rregullores komunale për kushtet, kriteret dhe

- procedurat e ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve;
5. Raporti për 6 (gjashtë) mujorin e dytë të punës së Kryetarit të Komunës.
 6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Përzgjedhës (DKA) sipas kërkesës së MAPL-së;
 7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm (hapja dhe ndërtimi i rrugës – Lagjja Bajram Curr);
 8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.001/011-38749 dt.10.03.2022 për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prizrenit;
 9. Shqyrtimi dhe miratimi propozim-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 001/011-99275 të datës 30 qershor 2023 për taksa komunale;
 10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vënien në shqyrtim publik të planit rregullues të hollësishëm “zona e parkut për industri të lehtë në Prizren - parku i biznesit”, sipas hartës zonale të Komunës së Prizrenit, (sipas kërkesës të MMPHI-së);
 11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratim paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024

Po Karanfil?

Karanfil Haxhillari (LVV): Dje në mbledhjen e komitetet për politikë dhe financa, ne vendosëm për renditje ndryshe, por sot po e shoh që pika e gjashtë, koka kontrabandu, nga në fund që ishte, paska dalë në fillim. Mirëpo, në komitet për politikë dhe financa, neve nuk e votuam këta, me sa mbaj në mend. Po qenka kontrabandu renditja e pikave të rendit ditës. Nëqoftëse edhe procesverbalet i shikon kryesuese, kjo pikë nuk u votu që të ndryshon renditjen.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ne ishim nëntë anëtarë aty prezent, ose tetë, së mbaj mend, ndonjëherë ka pasur lëvizje në momentin kur drejtoresha e propozoi që të jetë menjëherë pas raportit, unë, mesa e pashë, u dakorduat gjithë, edhe thatë që po e mbështesim kërkesën e drejtoreshës. Qoftë se ju kujtohet, unë edhe për pikën 11 tash që është propozova që të jetë ma lartë, ju e kundërshtuat, edhe e lamë kështu si është në fund. Ne ishim aty momentin kur e propozoi drejtoresha. Ju thatë që po e përkrahim propozimin e drejtoreshës. Mirë, kalojmë të procesverbalet, pastaj ndalemi te rendi i ditës. Shqyrtimi dhe miratimi procesverbali të datës 23 nëntor 2023. A ka dikush diçka rreth procesverbaleve? Qoftë se nuk kemi, atëherë prezent jemi 32 anëtarë. Kush është për që të miratohen procesverbali i datës 23 nëntor? 28 për, 0 kundër, abstenim 0. Atëherë, miratohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë te pika e dytë.

Pika e Dytë:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.

Adrit Krasniqi (PDK): Faleminderit kryesuese. Ne kërkojmë që pika e njëmbëdhjetë të transferohet, ose të bartet para raportit të kryetarit, domethënë në pikën pesë.

Dafina Alishani (LVV): Përshëndetje! Pasi që filluam seancën me përshëndetjen e kryetarit, unë i uroj mirëseardhjen kryetarit, mbas sa seancave që ka munguar. Për besë, na ka marrë malli me dëgjju kryetarit. Kështu që, propozoj që raportin ta kemi menjëherë pas pyetjeve dhe përgjigjeve, për shkak që jemi tepër të interesuar për raportin 6 mujor të kryetarit. Edhe jemi të interesuar pak me diskutu me të, për shkak që kemi pasur mungesën e tij në seancat të fundit. Andaj, edhe në rend ditës, kur është dërguar, ka qenë e para, nëse nuk gaboj, tash është zhvendos. Nëse edhe kolegë tjetër janë të pajtimit, që pas pyetjeve të kuvendarëve, të dëgjojmë kryetarit, edhe ta shohim se çfarë pune kanë bërë për gjashtë muaj. Faleminderit!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Mirë atëherë i kemi dy propozime, që pika e 11 të bartet si pikë 5 edhe pastaj pika e 5 të bartet si pikë 4 kështu po shkoj me radhë. Po Faruk?

Faruk Tahiri (LVV): Këtu nuk po nuk po shoh unë informatë të komisioneve funksionale që i ka kuvendi, normal bëhen çdo herë në fund vit dhe nuk ka pikë të rendit të ditës për këtë!?

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po Faruk, nëqoftëse je i njoftuar ne i kemi largu ato pika për shkak që e kemi pasur si renditje shumë të ngarkuar edhe e kemi lënë që jemi dakorduar me anëtarët e KPF-së, të bartet për muajin janar do të kemi.

Kështu, po shkojmë propozimi i parë ishte që pika e 11 të bartet si pikë e 5. Kush është për, prezent jemi 33 anëtarë, kush është që pika 11 të kalojnë pikën 5? 22 jemi për, kundër 10, abstenim 0. Atëherë pika e 11 kalon pikë 5.

Po shkoj me propozimin tjetër, pra raporti i kryetarit që është në vendin e 5 të kalojë pikë e 3, kush është për të kalojë kjo pikë në vendin e 3, pik e 4 pas pyetjeve dhe përgjigjeve, 33 jemi prezent kush është për 19, kush është kundër 9, abstenim 1?

Tash, me gjitha këto ndryshime po e hedh rendin e ditës në votim 33 prezentkush është për? Unanimisht! ju faleminderit shumë miratohet edhe rendi ditës. Kalojmë te pika e tretë:

Pika e Tretë:

Pvetje e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme:

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Para se me marrë fjalën të nderuar anëtarë, ju rikujtojë të mundoheni që sa më shumë të respektoni kohën prej dy minutave. Mua më vjen keq edhe në këtë muaj nuk mundën zyrtar të IT-s me bë zgjidhje për shkak të monitorimit. Po shpresojë që ta fillojmë vitin, pastaj ta kemi minutazhin edhe në monitorë, përkundër përpjekjeve që kanë bërë, por nuk kemi mund me ardhë deri tek një zgjidhje përfundimtare edhe për këtë muaj. Atëherë Egzona fjalën, pastaj Petriti.

Egzona Hoxhaj (PDK): Faleminderit e nderuar kryesuese, i nderuar kryetarë, nënkryetarë, ekzekutiv, koleg kuvendar, media, shoqëri civile, qytetarë të nderuar të komunës Prizrenit. Atëherë, edhe në këtë seancë dua të ngrej disa çështje. Njëra prej tyre, më shumë është kërkesë, edhe pse e di që nuk është kompetencë e komunës, ka të bëjë me probleme të energjisë elektrike në komunën e Prizrenit, konkretisht edhe në regjionin e Hasit. Drejtori i shërbimeve publike është i njoftuar për shkak që shpeshherë më është dashtë më kontaktua ato, për shkak të mos përgjegjësisë së përfaqësuesve të të Kekut dhe mos qasjes së duhur që ata po i bëjnë qytetarëve të komunës Prizrenit. Prandaj, për shkak që jemi edhe në fund vitit dhe e kemi festën e fund vitit afër, kërkoj

drejtor që me mbajt një mbledhje ose një takim urgjent me ta, edhe më kërkua përgjegjësi prej tyre, për shkak që është e dhimbshme që po përfundojnë vitin 2023 dhe qytetarë të komunës Prizrenit, konkretisht banorët e fshatrave të regjionit të Hasit, po përballen me orë të tëra në terr dhe mungesë të vazhdueshme të energjisë elektrike, po në të njëjtën kohë edhe me probleme tjera që po ju shkakton shumë telashe.

Kërkesa tjetër i drejtohet drejtoreshës së arsimit. Drejtoreshë, edhe në seanca të kaluara kam bërë kërkesë që fëmijëve të lagjes Cakaj me ju mundësu transporti, për shkak që lagja Cakaj është në një distancë koga të largët prej fshatit Zym, edhe fëmijët po janë vazhdimisht të rrezikuar që me bë n 'këmbë këtë rrugë prej lagjes Cakaj deri në fshatin Zym. Kjo është kërkesë e vazhdueshme e prindërve që jetojnë në atë zonë, edhe po shpresojmë që planifikimin për vitin 2024 t'ju bëjmë një zgjidhje. Kërkesa tjetër për drejtorinë e arsimit, ka të bëjë më është drejtuar prej edukatoreve të institucionit parashkollor Zambaku. Edukatorët që janë stafi këtij institucioni kanë kërkuar që fëmijët e tyre që janë në këtë institucion të lirohen prej pagesave. Unë e di që ju jeni informuar, edhe po kërkoj nga ju të rishikohen mundësitë që të realizohet kjo kërkesë.

Për fund, për drejtorinë e shërbimeve publike. Drejtor, veç kisha dashtë me të falënderuar, pasi që jemi në përfundim të vitit për gjitha investimet që janë bërë në regjionin e Hasit. Për shkak që për këtë vit janë bërë investime që kanë periudhë shumë gjatë kohore që nuk është investuar. Edhe normalisht që unë e di për planifikimet për vitin 2024. Një prioritet që kisha kërkuar është fshati Kabashi në Has. Ju jeni njoftuar përmes mediave, por edhe përmes banorëve të fshatit për problemin e rrugës kryesore në atë fshat. Kisha kërkuar që të konsiderohet prioritet për fillimin e vitit 2024, me qenë ato investime. Faleminderit.

Petrit Hoxhaj (Guxo): E nderuara kryetare, i nderuar nënkryetar, drejtor, kolegë kuvendarë, media dhe qytetarë të nderuar. Sot është dita e tretë kur qytetarët e rajonit të Grazhdanik, Kobaj, Vlashnjë, Moradem, dhe sot do të bashkëngjiten edhe fshati i Poslisht, që kemi problem me energjinë elektrike. Ne e dimë se KEDS-i ka një projekt në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit për pesë vitet e ardhshme. Mirëpo, për çudi, nuk është paraparë në këtë projekt regjioni Grazhdaniki dhe fshati Kabaj, ku pikërisht nga këto dy lokalitete fillon problemi i tensionit të lartë. Të cilat janë të instaluar që nga vitet '60 dhe që nga ajo kohë nuk është shtuar asnjë shtyllë elektrike në atë pjesë. Prandaj, i nderuar drejtor, gjithmonë ke qenë në gatishmëri për tani në këtë lokalitet, shpeshherë edhe ja kemi bërë zgjidhjen. Por, bashkërisht me kryetarin dhe nënkryetarin, që të shihni një mundësi që të futni në investime në fazën e parë edhe këta dy fshatra, sepse pikërisht nga këta dy fshatra është duke ndodhur problemi. Shikojeni mundësinë, nëse është e mundur një bashkëpunim mes Kedsit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Sepse me të vërtetë fshati Kobaj dhe fshati Grazhdanik kanë mbi 15 ditë që nuk kanë energji elektrike. Unë nuk flas për asnjë emër të asnjërit fshat, por flas në emër të qytetarëve të Komunës së Prizrenit. Sepse nuk është zgjidhje që me ju ndalë dy fshatrave dhe pas fshati Vlashnje rrymë. Ne kemi rrymë, por nuk është zgjidhje. Zgjidhje mi lënë në terr edhe dy fshatra të tjerë. Prandaj, nesër në orën 11, përsëri kemi një protestë pranë zyrave të KEDS-it, dhe ju ftoj kushdo dëshiron nga asambleja të vijë dhe të bashkëngjitet për të shprehur pakënaqësinë që e kemi ne si lokalitet kundër këtij institucioni. Ne prapë themi që Komuna e Prizrenit nuk është kompetente, por Komuna e Prizrenit është kompetente për ta siguruar jetesën e gjithë qytetarëve të saj. Faleminderit

Bujar Hasani (i Pavarur): Faleminderit përshëndetje për të gjithë. Me thonë të drejtën, pata qejf për kryetarin po ai s'është prezent, megjithatë do të vazhdoj me timen. Pata të ja jap një kompliment sepse kanë ndikuar në zvogëlimin e papunësisë duke punësuar djalin e vet edhe nja

5 asambleistë më duket 4 apo 5, kështu që ka zbut, ka ndikuar në mënyrë pozitive në zvogëlimin e papunësisë. Ndërkaq, pyetja është për kryetarin, drejtorin e inspektorateve. A është drejtor i inspektorateve apo drejtor i zyrës së prokurimit? Nëse mundet me dhënë përgjigje për këto pyetje? Dhe në bazë të kësaj kam edhe një pyetje për drejtorin e inspektorateve. Sepse në në qytet, që po flitet, janë disa parcela, të cilat janë pronë e progresit. Ku aty një qytetar sipas gojëdhënave flitet që është kushërinj i drejtorit famshëm. Kanë ndërtuar objektin, kam edhe fotografitë, është ndërtuar objekti, është ndërmarr një masë, është grith aj objekt në emër të asaj kishe është ekzekutuar dhe janë këto prona të uzurpuara. Në këtë rast, unë shfrytëzoi rastin që të ftoj organet e drejtësisë të merren me këtë çështje. Sepse 3 prona janë të uzurpuara me objekte të ndërtuara. Unë kam fotografitë në qoftë se ka interes, po i kam nxjerrë fotografitë, janë të fotografuara edhe janë të ndërtuara të uzurpuara. Kërkojnë një përgjigje prej drejtorin, a është kushërinj jot i afërt apo dikush tjetër? Nëqoftëse mund me na dhënë një informacion, faleminderit.

Agnesa Sinanaj (AAK): Mirë përshëndetje për të gjithë. Unë kam një propozim. Rastisa një natë me hëngër darkë me një person të cilin e vlerësova jashtëzakonisht shumë nga qyteti Kukësit. Edhe në bisedë sipër rreth qytetit Prizrenit, e pashë se sa shumë atë na vlerësojnë edhe na donë neve. Edhe mendova si qytet, pse nuk e kërkojmë ne binjakëzimin me ta? Edhe si shenjë falënderimi për gjithë kontributin që e kanë bërë për neve në situatën e vështirë në cilën jena gjind. Mos harrojmë edhe me kujtu që ai është edhe kandidatë për çmimin nobel, për shkak ndihmës së madhe që ka dhënë ndaj neve. Edhe mu kish bërë shumë qejfi nëse e kishit pasur parasysh këtë kërkesë. Faleminderit shumë.

Islam Thaqi (LVV): Përshëndetje koleg kuvendarë, ekzekutiv, media dhe gjithë të pranishmit në këtë sallë. Unë i kam tre pyetje që i drejtohen tre drejtorive të ndryshme, po fillojnë nga drejtoria e parë për drejtorin e shërbimeve publike. A drejtor, për dallim nga vitet më parë, çështja e dekorimit të qytetit këtë vit është bërë në afat edhe me kohë. Nga se di se sa pengesa mund të dalin në prokurim, kësaj radhe, është bërë në afat edhe me kohë, për dallim nga vitet e tjera. Mirëpo, nga fillimi i dekorimit deri më tani, disa qytetarë më janë drejtu dhe kanë pas reagime të ndryshme për vlerën e dekorimit të këtij projekti. Pyetja konkrete është: Sa është vlera e këtij tenderi dhe a është bërë pagesa. Dhe a është e vërtetë se ky tender iu është dhënë një kompanie, e cila në punën e saj është regjistruar si kompani që merret si sallon mobilie apo zdrukëthari, apo ku di unë. Këto janë tre pyetjet për këtë çështje.

Për drejtorin e administratën. I nderuari drejtor, pas shumë kohe më rastisi që të kem punë private në hapësira të administratës. Dhe atë ditë më ndodhi një skenë shumë kështu ta quajmë ndoshta dhe qesharake, veç në hyrje të objektit të dera rrotulluese është shenja ‘mos e shtyej derën’ për shkak se është me mekanizëm, edhe duke prit që dera të lëviz ajo nuk lëvizte derisa nuk u afrua pjesëtar i sigurimit e që ta shty atë derë. Pyetja ime konkrete është: A ka kontratë për mirëmbajtje, ngase edhe informacionet që kam edhe tualetet brenda objektit të administratës, sidomos në katin e parë, nuk janë funksionale dhe a është kjo arsyeja që nuk ka kontratë për mirëmbajtje të objektit? Do të po vërehen dëmet që janë bërë.

Për drejtoreshën e arsimit, drejtoreshë, shumë prindër të nxënësve të shkollës Fadil Hisari, më janë drejtuar me pakënaqësitë e tyre rreth punimeve që janë tu bërë në shkollën Fadil Hisari, në këtë kohë ngase siç jam informuar nga klasa 5 deri në klasën e 9 fëmijët vijojnë mësimin në shkollën më të afërt Mustafa Baki. Mirëpo, ankesat e tyre konkrete janë se; a është e vërtetë se orët e mësimit mbahen me orar të shkurtuar nga 30 minuta edhe shumica prej tyre kanë vërejtur se ka ra sukcesi i fëmijëve tyre gjatë kësaj periudhës sa po ndodhë kjo në shkollën Fadil Hisari. A mundeni me më

dhënë informacion pak më të qartë, ... projekti bëhet, që shumica e prindërve të këtyre fëmijëve nuk janë të informuar për çfarë projekti bëhet në shkollë dhe arsyeën pse janë duke vijuar mësimet në shkollën Mysafa Baki. Ju faleminderit.

Drita Qenaj (PDK): Faleminderit kryesuese, përshëndetje për kryetarin e komunës zotin Shaqir Totaj, ekzekutivin, koleg kuvendar, media dhe gjithë të pranishëm. Çështjen që do ta ngre sot është për drejtorinë e shëndetësisë, që disa herë kam ngrit këtë çështje dhe nuk është marrë parasysh fare. E nderuara drejtoreshë, qendra e mjekësisë familjare në Romaj punën vetëm me një ndërrim, domethënë deri në orën 2 e gjysmë, dhe kërkoj nga ju që kjo qendër të punojë me dy ndërrime pasi që shumë fshatra të Hasit i kryejnë shërbimet shëndetësore dhe është mëse domosdoshme. Për shkak të largësisë 25-30km në Prizren shpesh herë ka ndodhur që pacientët gjatë rrugës dhe të vdesin. Kështu që, stafin e kemi vendosur prandaj çfarë kërkojmë nga ju është ajo që vetëm të jepni urdhër dhe të fillojmë dhe me ndërrimin e dytë.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit kryesuese, përshëndetje kryetar, ekzekutiv, kuvendar, media dhe qytetarë. Desha të ndërlidhem me kërkesën e Petritit i cili e ngriti si shqetësim në lidhje me energjinë elektrike, edhe të njëjtën gjë e diskutoj edhe unë më këtë problem, pasi që e përmend edhe Kobaj e Grazhdanik dhe unë prej atij vendi vij. Veç si informacion domethënë para se me fillu protestë, unë kam qenë direkt jam taku me drejtorin e Kedsit edhe nuk na kanë marrë parasysh hiç, veç ta bën rrafsh dhe nuk kryhet kjo punë hiç. Pastaj, banorët e atij vendet kanë organizuar protestë të cilën nuk kam marrë pjesë aty, për shkak se e dijmë që të njëjtën gjë kishte me thënë edhe me protestuesit. Unë, kisha kërku nga kryetari ta shfrytëzoi autoritetin, e di raportet e di që Kedsit është një kompani private dhe që është shtet në veti me një farë mënyrë, po me na bo një zgjidhje sepse aty ka probleme shumë të mëdha. Unë pikërisht janë prej Kobajt edhe e di se saktësisht sa probleme kemi me rrymë, edhe rryma ndalet vazhdimisht, thujse çdo ditë ndalet mbi 10 herë edhe tu e ditë që sot gjitha shtëpitë janë me rrymë domethënë e kanë nxemjet me rrymë, qoftë me pelet, qoftë me dru, prapë rryma duhet për me aktivizuar ato pompat edhe është ftohtë dhe kanë shumë probleme. Por, edhe që është bërë një planifikim aty, e kam pa që sistemi elektrik në 2024 e që nuk është përfshi Kobaj dhe Vllashna nuk e di qysh e kanë bërë atë planifikim tu pasur parasysh që prej asaj ane problemi më i madh është te sistemi, te rryma domethënë qeta dy fshatra që i përmendi edhe Petriti. Domethënë aty me marrë masa ndoshta edhe me i shti në projekt 2024, që thjeshtë mos të na nxen edhe viti i ardhshëm dimri domethënë me qetë problem, i cili një frymë shumë e vogël, ka me na qitë problem neve me rrymë elektrike. Domethënë nuk është që s'ka hiç, po nuk i përballon trafa-fazat kanë problem edhe kemi shumë probleme të mëdhaja, faleminderit shumë.

26:00-32:26

Agim Muçaj (AAK): Faleminderit, përshëndetje kryesuese, drejtori, koleg kuvendar, përshëndetje qytetar. Unë kam 1 shqetësim për banorët e komunës së Prizrenit, përgjithësi duke u thirr nga Malësia e Re, Korishë dhe të gjitha fshatrat që janë në zonën kufitare me komunën e Therandës, kisha kërkuar 1 përgjigje publike, është nga drejtoria për gjeodezi kadastër apo nga ministria sepse ka shumë banorë, të cilët kanë probleme me pronat e veta edhe ndër familjare, të cilat nuk kanë lista poseduese as me Prizren dhe as me Therandë. Kush duhet ta japë llogari se pse njerëz donë zgjidhje, kanë probleme të brendshme dhe familjare që ato lista poseduese nuk

qëndron as me Prizren as me Suharekë qoftë zona neutrale. Kisha dashtë 1 përgjigje të mundur, si këta banorë mund ti zgjidhin këto probleme të cilat janë në kontest me zonën, faleminderit.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. Unë kam 2 çështje për mi ngrit për drejtoreshën e drejtorisë komunale të arsimit. Kompensimi i udhëtimit drejtoresh të mësimdhënësve, pra realizohet përmes transportit publik. Mirëpo, kam pas rastin në praktik ku orari i mësimi nuk korrespondon me transport publik. A jeni e njoftuar me këtë problematike edhe sa mund të jetë kështu e shtrirë në masë? Dhe e 2-ta në fshatin Romajë, shkolla e mesme dhe shkolla fillore dhe para fillore po mbajnë mësim bashkë. Po besoj jeni të informuar edhe orët aty janë 30 minuta, më shumë 35 ka edhe orë 40 minuta, mirëpo asnjëra prej orëve nuk mbahet në bazë të kritereve. Kam 1 propozim të cilën do ta sjellim edhe të shkruar, ju lutem në gjysmë vjetorin e 2-të, për shkak se nëse vazhdon kështu, ky mund të quhet vit i humbur. Në gjysmë vjetorin e 2-të mund ta bëni riorganizimin, e kemi në paralelen në Lukinaj të Hasit ka hapësira të mjaftueshme, aty mund të bëhet 1 zgjidhje. Për shembull, mund të vendosni nxënës të shkollës mesme ndërsa shkollën fillore te banorët e fshatit Lukinaj mund ti transportoni për një gjysmë vjetor në Romajë, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Selman, dikush tjetër?

Drita Qenaj (PDK): Kryesuese, që se ka mundësi 1 përgjigje. Po për shkollën, unë jam përgjegjëse për shkollën e mesme për shkak të objektit që është tu renovu me kërkesën e prindërve. Dmth që kanë pas ankesa prind, udhëtojnë nxënësit prej 10 fshatrave aty dhe është kohë momenti kjo, që dy javë e kemi ndryshu orarin dmth deri në funt të gjysmë vjetorit edhe në fillimin e gjysmë vjetorit e normalizojmë. Kështu që, më rëndësi shkolla po ndreqet, po bëhet shumë mirë investime po bëhen në arsim, këto s'janë kurrë janë kaluese!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit shumë! Të lutem shumë shkurt.

Selman Sokolaj (LVV): Shumë shkurt, unë e kam orarin e drejtorit këtu dikun nëse doni ua sjell edhe duhet me kanë pak më seriozë, orari tregon prej fillimit është orari i njëjtë. Ne kemi aty të afërm kemi fëmijë, kërkesa ime ishte kjo, drejtoresha mundet me iu përgjigj me kërkesë të prindërve, ne s'kemi parë ndonjë kërkesë të prindërve, mundem me i organizu' prind, mundem me bë peticione. Mirëpo, unë po pres përgjigje prej drejtoreshës edhe sot e marra vesh që zonja Qenaj qenka përgjegjëse, tash duhet me shiku a ka të drejtë asambleistja të ketë një rol menaxherial në shkolla. Shumë mirë që fole, faleminderit shumë!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Dikush tjetër prej anëtarëve të kuvendit sepse nuk kemi anëtarë që janë lajmëru me marrë fjalën, po Dritoni?

Driton Daçi (PDK): Faleminderit kryesuese, përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtor, ekzekutiv, koleg kuvendar. Pata një çështje, pyetje për drejtoreshën e arsimit. Drejtoreshë, a kërkesa për pushim pa pagesë nga mësimdhënësit edhe a është ndonjë numër që është shqetësues për drejtorinë, apo suaza të normales për shkak të emigrimit jashtë shtetit! Një pyetje tjetër për drejtorinë e shërbimeve publike, drejtor të falënderoj për investimet që po bëhen, janë dy procka një shteg për këmbësorë dhe sidomos trotuari në rrugën që shkon për fshatin Zojz, lagjja Elshani, Bytyqi edhe Berisha, ka qenë shumë i rëndësishëm por disi kanë ngec te prockat kur po ka reshje të shumta të shiut, ende pasi që janë të papërfunduar projektet po shkakton ende dëme edhe pse

është niveli dëmeve për shumë shumë më i vogël në raportet që ka qenë të kalumen. Po njëfarë përgjegjësie nga kompanitë cilat i kanë fituar këto tenderë, nuk po i rrinë shumë karshi fjalëve që i kanë dhënë fillim në komunitet aty se do ti përfundojnë shumë shpejt. Një pyetje tjetër për drejtorinë e administratës: kur do të fillojnë zgjedhjet e kryetarëve për këshilla lokalë? Edhe për drejtorinë e kulturës rinisë dhe sportit: një pyetje drejtor, sa projekte t përbashkëta i keni pasur me ministrinë e kulturës dhe sportit, sa ka qenë shuma që ka ndihmu pasi që nga organizatat joqeveritare të cilat e bëjnë monitorimin e ministrisë, kam vërejtë se investimet kapitale në ministrinë e kulturës rinisë dhe sportit shkojnë mbi 80% suficit. Kjo dëshmon faktin se shumë stadione qyteteve dhe janë në gjendje të mjerueshme, edhe jepni dëshmi të saktë se mbi 80% buxhetit për investimet kapitale me i tepru një ministrie, gojën plotë rini kulturë dhe sport ndërsa veprat janë për me të ardhë çudi, faleminderit!

Ertan Simitçi (YTHP): Değerli Prizren halkı, saygı değer meclis üyeleri ve katılımcılar, hepimizi saygıyla selamlıyorum...

Bugün konuşacağımız birçok konu varken, ben özellikle de, trafik uygulamaları ve son zamanlarda artan trafik kazalarına dikkat çekmek amacıyla söz almış bulunmaktayım.

Malumunuz, son zamanlarda şehrin içerisinde ve etrafında, trafik kazalarına ve dolayısıyla maalesef üzücü haberlere şahit olmaktadır.

Araştırmalara göre bunun iki nedeni var:

1. Sürücülerin trafik konusundaki bilgi, disiplin ve eğitim yetersizliği;
2. Trafik işaret uygulamalarının yetersiz veya eksik olması;

Dünyanın bütün büyük şehirlerinde bu iki konu üzerinde devlet veya belediyeler özel çalışmalar ve uygulamalar yapmaktadır.

Örneğin, bizim de Belediye olarak:

- Ana caddeler başta olmak üzere şehrin içerisinde yatay ve düşey trafik işaretlerinin artırılması;
- hız kesici ve hız uyarıcı levhaların eklenmesi;
- yol aydınlatma, ışıklandırma ve yol çizgi çalışmalarının artırılması;
- mobese kameralarının acil olarak hayata geçirilmesi;
- yayalar için daha güvenli trafik uyarıcı çalışmalarının yapılması;
- Trafiğin yoğun olduğu ve hız yapılan caddelerde hafif kasislerin eklenmesi;
- epoksi zemin ile uyarıcı yöntemlerin yapılması;
- çift kompenantlı yol çizgilerle hız kesici yöntemler, trafik kazalarını önleyen ve azaltan uygulamalardır.

Değerli meclis üyeleri,

Daha geçen hafta Prizren'de iki üzücü olay yaşandı.

Otobanda hız yarışı yaparak kaza sonucunda üç gencin ölümü ve şehrin içerisinde yaya geçidinde bir gencimizin çok ağır bir şekilde yaralanması.

Gerekli önlemler alınmadığı takdirde, hepimizin başına gelebilecek olaylar bunlar. Yarın, belki bize, belki de çok sevdiğimiz insanlarımızın başına da gelebilecek olaylar bunlar. Bu yüzden çok acil olarak trafik kazalarının en aza indirebilmek için ne gerekiyorsa onun yapılmasını şiddetle öneriyorum.

Bütçedir, paradır, ihale süreçleridir, gibi mazeretler hiçbir canın, hiçbir insanımızın yaşamından daha kıymetli değildir!

Sayın Başkan,

Bu konudaki hassasiyetimizi dikkatle ve özenle gündeme taşıyacağınızı umut ediyor; trafik kazalarının azaltılması için ilgili kurumların yetki ve görev alanlarında derhal çalışmalar yapmasını talep ediyor; sürücülerin ve halkımızın trafikte daha dikkatli ve tedbirli olmasını temenni ediyorum.

Saygılar sunuyorum.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): faleminderit, fjalën e ka Bajram Kastrati. Përgatitet Ilir Gashi.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese, përshëndetje kryetar, nënkryetar, ekzekutiv, koleg kuvendar. Shumica prej kuvendarëve filluan me falënderime, unë desha t'i falënderoj secilin drejtor pa dallim, respekt për punën për secilin veç e veç. Fjalën e mora pikërisht për çështjen e aksidenteve, unë veç po dua me shtu edhe një pjesë ku policia i kanë disa pika të zeza i quajnë ata, që vazhdimisht jam dëshmitarë i rastit dhe kohën e fundit këtij djali të ri, ndodhin aksidentet të shumta të njëjtin vend. Drejtor, keni marrë vendim që mos më bë ngritjen në pengimin e veturave, gjë që është shumë e mirë, për së paku në këto pika po i quaj të zeza, prapë siç e quajnë policia. Të keni parasysh dhe të merrni masat se jam thashë dëshmitarë i disa rasteve të njëjtin vend, faleminderit.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zoja kryesuese, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Edhe unë do të filloj me problemet në komunikacion. Kohëve të fundit vazhdimisht po na përcjellin lajmet për aksidente të shumta, për fat të keq edhe me fatalitete dhe me lëndime të rënda trupore dhe nga takimet që i kam me qytetarë të shumtë, takime të rregullta, ky shqetësim na breng të gjithëve. Dhe kërkesa e komunitetit është që komuna e Prizrenit të ndërmer masa preventive për parandalimin e aksidenteve. Në bisedë me zyrtarë komunal mora vesh që këto pengesat, apo polisë të shtrirë i thirrëshim më herët, ndalohen me ligj. Nuk e di sa është i sigurt, sa është i vërtetë ky pretendim. Po megjithatë, komuna e Prizrenit duhet të gjejë alternativa për parandalimin e aksidenteve brenda në qytet, duke gjetur forma të ndryshme inovative, sepse qyteti është i vogël, rrugët janë të ngushta me shumë kthesa, me shumë këmbësore që hecin, me shumë biçikleta e motoçikleta, që të ndërmerren masa të ndryshme, që inxhinierët e komunikacionit me siguri duhet të kenë asi që në të ardhmen të parandalohen aksidentet që po ndodhin në komunën tonë, dhe të shpëtojmë jetën dhe shëndetin e qytetarëve. Një kërkesë tjetër nga banorët e lagjes Saraqane, aty ku janë zyrrat edhe partisë juaj. Punimet po shkojnë shumë ngadalë, dhe është një tollovi shumë e madhe dhe pengesë e jashtëzakonshme për banorët e asaj ane. Po ashtu, rruga nga aty që del në rrugën "Femi Ladrovci" është një kakshe, po tani po shfrytëzohet për dy kahje, dhe po krijohet një tollovi e madhe që po shkakton edhe pengesë për banorët e lagjes, por edhe për ata që frekuentojnë këto rrugë. Drejtor, ju lutemi të bëni një zgjidhje, të bëni rrugë alternative të përkohshme, të ndërroni kahjen e rrugëve, pse jo edhe të keni bashkëpunim me policinë, që të menaxhohet sa më mirë ky kaos që është zhvilluar në qytet, për shkak të punimeve të shumta që po zhvillohen në të njëjtin kohë në disa pjesë të qytetit. Drejtor Lamaj, një ankesë kam pranuar nga banorët e lagjes Dardania Jaglenica që semaforët këtu nuk punojnë që disa muaj, edhe aty ka aksidente që ndodhin. Shikova në faqet e komunës por nuk munda të gjej kontratën për sinjalizim. A keni lidhur kontratë me ndonjë operatorë ekonomik, nëse po, a mund të kem qasje në atë kontratë, sepse nuk ishte në faqen e komunës. Po ashtu, banorët e njëjtë kanë kërkuar që të sanohet edhe një gropë që është në mes të rrugës, që shpie në drejtim të xhamisë në lagjen Dardania. Është sanu? Dmth masi e bënë publike

apo? Në rregull! Faleminderit shumë, atëherë po shpresoj që edhe për kontratën për sinjalizim të ta kemi qasje, nëse është lidhur me ndonjë operatorë ekonomik. Nëse jo, ta dimë pse nuk është e lidhë? Është fundi i vitit, drejtor, edhe sa ditë na kanë mbetë? edhe dy ditë më duket! Jo jo, ka qenë buxheti 100 mijë euro, për 100 mijë kanë qenë të ndame. Në rregull, faleminderit për n 'dëgjim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, Ilir. fjalën Karanfil Haxhillari, përgatitet Faruk Tahiri

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit, kryesuese, ekzekutivë, të nderuar kolegë kuvendarë. I kam disa çështje apo pyetje, me thanë drejt, më qartë. Pyetja e parë shkon për kryetarin, meqenëse moti s'e kemi pa. Neve e dimë që Krusha e Vogël është vendi ku masakra më e madhe që është bë nga pushtuesi serb, e kemi Krushën e Vogël. Dhe në qeverisjen e kalume është fillu memoriali i martirëve të Krushës së Vogël 80% të varrezave janë ndërtu, po edhe në memorial ka punime. Qe dy vite asnjë lëvizje sa i përket këtij memoriali të Krushës së Vogël. Dhe me të vërtetë, më 26 mars, që është përvjetori i këtyre martirëve, nuk e di se a do të kemi fytyrë për me shku për me ba homazhet e ta. Dhe pyetja shkon: a doni me e lanë qashtu dhe edhe ai investim që është ba me shku damë, apo do të ndërmerri masa që vetëm edhe njëzet për qind të punimeve ju kanë mbetë dhe për me e përfundu. Për Drejtoreshën e Shëndetësisë,- Drejtoresh, në AMF, e cila mbulon lagjen Dy Korrikun, 11 Marsi dhe Petrovën, që nga shtatori i këtij viti vaksinimi apo shërbimi për vaksinim nuk kryhet në këtë AMF. Pra, aty banojnë mbi mbi 80 mijë banorë, përfshirë këto tri lagjet dhe obligohen qytetarët e këtij lokaliteti që të shkojnë nëpër QKMF apo AMF-të tjera që të marrin shërbimin e vaksinimit. A jeni në dijeni sepse tekja e një punëtori aty për mos të shku në punë dhe të mbesin pa shërbim dhe nuk ka të bëjë me vaksinim covid, po me vaksinat të cilat janë obligative për fëmijët tanë që jetojnë në atë pjesë! Kjo në Paris drejtoreshë dënohesh me ligje dhe në burg kishit shku! U fol shumë këtu për shërbimet publike dhe për komunikacionin, për mos me u zgjat dhe me e mbajtë të dy minutëshin tim, unë dua vetëm me e bë një krahasim. Nga rrethi i Bazhdarhanës deri në spitalin e Gjakovës është distanca kohore për 50 minuta, mundet me arritë, kurse prej Bazhdarhanës në spitalin e Prizrenit për 40 minuta, arrin tash. Është kaos total urbanistik, kaos që me të vërtetë drejtorë nevojitet një zgjidhje urgjente. Neve e kuptojmë kur ka fluks të madh të makinave, e kuptojmë, por ato të cilat më herët i proklamoje si vizione, po dalin që po të dalin kundër vizione. Dhe kjo është me të vërtetë kurrë kesi kaosi, kurrë kesi kolone nuk ka pas qyteti i Prizrenit. Duhet zgjidhje sa më të shpejtë, në fund të fundit aman ta ktheni në gjendjen qysh është ka qenë, sepse është bë e tmerrshme komunikacionin, është bë i tmerrshëm komunikacionin në Komunën e Prizrenit. Faleminderit!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, zotëri Haxhillari! Fjalën e ka Faruk Tahiri.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese! I nderuar kryetar, të nderuar drejtorë, kolegë kuvendarë, të nderuar qytetarë. Unë kam disa pyetje edhe për kryetarin, edhe për drejtorin e shërbimeve publike. Njëra prej pyetjeve apo kërkesave me thënë të drejtën, për shkak se ne si Komunë nuk kemi qasje në kuptimin e imponimit të Kedësit në investime, mirëpo aty ku investohen me është mirë që me bo plane që me i fut edhe pjesën ku kanë interes qytetarët, është puna për energjia elektrike kur vendoset për parkun e biznesit në Korishë, që të njëjtën furnizim ta kenë edhe biznese që janë rreth rrugës, nga tensioni i lartë, ku fillon te Hibi e deri në pjesën e Korishës, se është një numër i madh i bizneseve që për shkak të investimeve të vogla që bënë

KEDS-i nëpër fshatra siç është Korish e Malësie e re, me një frymë shumë të vogël komplet bizneset mbesin pa rrymë në atë pjesë. Dhe është mirë që të planifikohet kur dërgohet rryma në parkun e biznesit, në të njëjtën furnizim të lidhen edhe të gjitha bizneset që janë në atë rrugë. E kam një pyetje edhe për drejtorin e shërbimeve publike që është është bë edhe herën e kalume, po nuk kam marrë përgjigje nga drejtori. I nderuar drejtor, kur po bëni investimet në në rrugë nëpër lagje të ndryshme. Jam i interesum me ditë a njoftohen qytetarët aty për ato investime, se ka ndodhë në një lagje ku pa dijeninë e qytetarëve të asaj lagje është fillu mu ndërtu diçka dhe pastaj është blloku investimi në në atë lagje. Prandaj, është mirë që për çdo investim që bahet, paraprkisht të njoftohen qytetarët për investime që doni me i bë në atë rrugë. Në të njëjtën kohë do doja të shpreh një falënderim për një intervenim shpejt, në dy raste që kem kërku nga ju, kërkesa ka ardhë te unë nga qytetarët për heqjen e pengesave në rrugë, operatori e ka kry me kohë intervenimin, si dhe në një rrugë tjetër, ku shtylla elektrike lëvizte për shkak që operatori ekonomik e ka bërë gropën dhe nuk e ka shtypë fare dhe shtylla elektrike ka fillu të lëvizë dhe ka... ka bërë një shqetësim tek qytetarët. Prandaj, dhe të falënderoj për intervenime të shpejta, por do të ishte mirë sikur të keni ekipe përcjellëse, mbikëqyrëse të punimeve të operatorëve, për shkak se është cilësia shumë e dobët e investimeve që po bëhen nëpër komunën në Prizren. Gjithashtu, i nderuar drejtor, në rastin ku ka ndodhë aksidenti, kur u shkel një qytetar në në zebra. Aty është edhe një shenjë, ku thotë, nuk është vetëm te ajo pjesë, po janë në unazën e parë diku pesë-gjashtë vende, shenjë ku thotë ka policë shtrirë. Dhe kur është bë renovimi i rrugës kur është shtru rruga aty, te unaza, janë heqë të gjithë ato policë të shtrirë, nuk ka më policë të shtrirë, mirëpo shenjat ekzistojnë. Do të ishte mirë që kur boni ndryshime, t'i boni ndryshimet e menjëhershme, edhe të sinjalizimit, edhe të asaj që është real në terren, se nuk ka mundësi sinjalizimi me tregu diçka tjetër, kurse gjendja në terren me tregu diçka tjetër. Edhe një pyetje për kryetarin. E kam bërë këtë pyetje para gjashtë muajve për klubin futbollistik Liria, i nderuar kryetar. Kam thënë si ka mbetë statusi i klubit futbollistik Liria në atë kohë ishte e paqartë kush është pronari, a OJQ-ja apo pronari që e ka privatizu klubin. Ju keni thënë, kryetar, se jemi duke testu investitorin se a do t'i bëjë gjithë ato investime, pastaj do të shohim çka do të bëjmë me të. Sot klubi është bartë në pronësi private, kurse kur nuk ka qenë më keq përfaqësimi i sportit në Superligën e Kosovës, siç është tash Liria, që është e fundit në tabelë dhe pothuajse nga pesëmbëdhjetë ndeshje ka vetëm një fitore. Vetëm një fitore dhe është tmerr, është mjerim dhe nuk ka asnjë reagim për këtë punë, se çka po ndodh? Duke pas parasysh se e kemi pas një premtim shumë të madh që do të investohet në në atë klub, kurse sot po shohim që jemi duke shkuar përsëri aty ku kemi qenë edhe vitin e kalum. Uroj të mos ndodhë një gjë e tillë, mirëpo, do të kisha pas dëshirë si ju ka bind kryetari i tanishëm apo investitori që i ka kry gjitha ato premtime që ju keni thënë e kemi një test, që me ia kalu pronësinë komplet një privatniku. Faleminderit!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit! Fjalën Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit, të nderuar qytetarë të Prizrenit, ju të nderuar ekzekutiv dhe kolegë të dashur. Pasi që është seanca e fundit për këtë vit, duhet të hap fjalimin duke ju uruar një vit të mbarë me shëndet dhe mbarësi, të gjithë qytetarëve dhe juve të pranishëm. Po ashtu, pasi që u kërkua energji pozitive nga kryetari, po e fillojmë çështjet me një propozim pak kritik dhe një propozim konstruktiv të cilën do të doja ta bëjmë sa më shpejt që është e mundshme. Propozoj tek drejtorja e shëndetësisë që ta kemi një rregullore për kujdestari të barnatoreve të qytetit. Besoj që kemi shumë shembuj nga komuna tjera që mund t'i marrin dhe ta përpilojmë një edhe për komunën e Prizrenit, për shkak që ka shumë kërkesa dhe ankesa nga qytetarët lidhur me këtë çështje.

Po ashtu, vazhdoi me pyetjet, edhe pse kolegu im Karafil e ngriti si çështje, por pasi që një familjar i Krushës Vogël i martirëve e ka paraqit këtë kërkesë, dhe unë dua të ngris si shqetësim. Është çështja e ndërtimit të memorialit dhe varrezave në Krushë të Vogël. Çka është arsyeja e mos punës në këto varreza? Dhe ju partitë të cilët thirrreni shumë për luftë, pse i keni harruar martirët e luftës dhe a shumë shumë gjë po ju kërkon një mirëmbajtje të varrezave dhe një investim minimal që do të ishte e mundur për juve. Ju lutem që ta keni parasysh këtë kërkesë dhe ta bën investimin aty që kanë mbetur gjysmak dhe që me muaj të tanë nuk është punuar.

Vazhdojmë me drejtorinë e shëndetësisë. Drejtoreshë, barnatorja Qkmf-së ka sipërfaqe prej 20-25 metër katror, por aty i keni 7 punëtorë. Së fundi, e keni hapur edhe një konkurs të 8-in po doni me punësuar! A nuk po mundeni me i rahatu dika tjetër apo çka është çështja që 7 punëtorë në 20 metër katrorë po doni me i rahatu? Hajde po supozojmë që është nevoja për shtatë punëtorë aty, a e dini që ka pleq që presin me orët të tëra për mos shërbim? Tash ose ka një mos menaxhim të duhur aty ose prioritetet e keni punësimet e të afërmve tuaj, edhe shërbimi është dytësor. Ju lutem të na tregoni pse ka nevojë një objekt ose një hapësirë kaq e vogël me pas kaq shumë punëtorë, edhe pse bash shokët e juaj. Po ashtu, e kam pyetjen për realizimin e punëtorisë për hartimin e të gjeturave gjatë procesit të implementimit të projektit që quhet vizitat shëndetësore sistematike nëpër shkolla.

Sa ka kushtuar kjo vizitë? Sa persona kanë marrë pjesë në këtë vizitë si dhe cili operatorë ekonomik e ka realizuar këtë shërbim? Ju informoj që kjo kontratë nuk është në web faqe dhe kjo dëmton transparencën e komunës. Pyetja e fundit për juve drejtoreshë, është tenderi për furnizim, instalim dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe të programit për faturim, e cila ka kushtuar 80 mijë euro. Ky shërbim sigurohet nga niveli qendror, nuk e di pse keni nevojë më hapë kesi lloj tenderë që kushtojnë 80 mijë euro, kur veç është një shërbim i siguar nga niveli qendror. Edhe pse ka mungesë të filmave dhe rrengentit, pse nuk ka filma edhe kur po planifikoni më bë sigurimin e këtyre filmave, për shkak që ka ankesa prej qytetarëve që ka mungesa?

Kaloj tek Dka-ja, edhe pse ka thënë dje që nuk do t'ju përgjigjem, veç do t'ju uroj vitin e ri. Mendoj që kjo çështje është një çështje shumë serioze, të cilën e kam pranuar nga prindërit: çerdhja 11 Marsi nuk ka pasur nxemje disa ditë. Arsyeja e kësaj edhe a është mënjanoar ky problem, nëse është diçka që është ndonjë problem që nuk mund të mënjanohet, së paku me i informu prindërit, edhe ta bëjmë një zgjidhje sepse është për të ardhur keq nëse nuk mund t'ia sigurojnë fëmijëve së paku nxemje në çerdhe.

Drejtoria shërbime publike, drejtor, edhe sa herë do ta meremetoni rrugën e shtruar tek Tea-ja. Edhe punimet në rrugica, kryesisht qytetarët po kanë ankesa për stërgjatjen e punimeve. Unë vetëm dua të di, ju si menaxhment i Dshps, a keni pasur ndonjë reagim ose ndonjë vërejtje karshi operatorëve ekonomikë në mënyrë që të rrisin tempon e punimeve, apo i presim qysh i kanë kontrata dyvjeçare dhe qytetarët duhet ta dinë që deri në fund kontratës operatorët ekonomik do ti kryjn. Do të ishte mirë së paku këto nyjet të cilat po e bllokojnë trafikun, ta kenë një presion më të madh nga ana juaj, që në mënyrë të kryhen punët më shpejtë.

Drejtoria e turizmit, drejtoreshë, sa prej shtëpizave tek dimri kulturor i takojnë kabinetit dhe të afërmve të kabinetit të kryetarit? Sa prej tyre militantë partiakë? Dhe sa prej tyre biznese? Këto do të ishte mirë të na tregoni. Edhe së fundi, pasi që është fundi i vitit edhe pasi që e kemi këtu prezent kryetarin, unë dua të ju bëj thirrje secilit prej ekzekutivit, po më së shumti drejtorit të kulturës.

I nderuari drejtor, ka dy vitet që bëj kërkesa dhe lutje për juve, por edhe për gjithë ekzekutivin, edhe kërkesat kryesisht që i ngrisë ose i analizojë ose e gjej një elementë që ka dyshime dhe pastaj e ngris këtu. Domethënë nuk vij unë më asnjë kërkesë që nuk e kam analizu, ose nuk e kam pa në detaje. Disa herë unë jam mundu' me një kulturë me ju lut, me ju thonë me fjalë më të buta, mos

na lajthitni, mos na dezinformoni, mos na keq informoni, bile bile ju kam pyet a jeni të sigurt, se unë e kam informatë ndryshe, po po e shoh bre këtu nifarë tendencë me dalë këtu në foltore edhe me na gënji neve kuvendarëve, që kjo s'është e mirë. Nuk muj unë me fal një drejtor me dalë në foltore edhe me thënë 'po sigurt unë, nuk kam asnjë investim pa leje' pas 2 ditëve kur bëj unë qasje, me mi qu tre ndërtime pa leje! Ta kemi pak, a din njerzillëk me pas karshi kuvendarëve. Unë shumë më shumë e çmojë prej secilit prej juve me dal me thënë 'nuk e di' ose nëse dhe keni në afekt keni dezinformu ose keni gënji, por vjen keq që po ju them që po gënjeni, me gënjeu dilni këtu edhe njerëzore është me thënë më falni, por nuk e kemi pasur këtë informatë.

Unë uroj që edhe mbrëmë keni kaluar mirë tek pjesa ku i keni pasur laureatët e vitit. Mendoj që i ke hi në hak vetes, pinoku i këtij viti je ti! Ishte dashur që ti te kesh një mirënjohje sepse është hera e tretë që ti mua më gënjen në këtë kuvend. Neve dikush na ka besuar këtu, edhe ne po vijmë këtu me çështjet të cilat qytetarët po na kërkojnë. Nuk e meritojmë asnjëri prej drejtorëve edhe kryetar po të lutna, edhe ti kërkoji ekzekutivit mos me dalë foltore me na gënji.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit! Adem Shabanaj fjalën e ka.

Adem Shabanaj (LVV): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, nënkryetar, të nderuar drejtorë të ekzekutivit, kolegë kuvendarë, media, të tjerë të pranishëm.

Meqenëse është seanca e fundit e këtij viti, më lejoni që gjithë qytetarët e Prizrenit t'i urojnë për një vit të ri, me shëndet dhe me shumë suksese. Po e filloj me një shqetësim për policinë e Kosovës, meqenëse ndoshta nuk i takon komunës. Mirëpo, në takimin e parë kryetar që do ta keni me policinë e Kosovës, është mirë që ta ngritni si shqetësim. Unë jam banor i lagjes së Trimave dhe në hyrje të lagjes është spitali rajonal i Prizrenit. Është një hapësirë kogja e mirë aty ku rrinë taksistë tek rampa, te barnatoret në hyrje të lagjes së Trimave, e cila ka hapësirë, por nuk është për parkingje, e kuptojmë këtë. Mirëpo, nuk është asnjë shenjë që e ndalon parkimin aty. Sigurisht, banorët e lagjes e kanë kuptuar një gjë, se policia e Kosovës vazhdimisht çdo ditë, po është më e keqja që i njëjti polic me të njëjtën kompani të bartjes së merimanga në gjuhën qysh i thirrim ne, vjen edhe i merr veturat në atë pjesë. Të paktën të bëhet një shenjë e komunikacionit, e cila e ndalon parkimin dhe tregohet që nëse vendoset makina këtu, do të zhvendoset në polici. Sepse vijnë qytetarë prej rajoneve të Prizrenit, Rahovec, Suharek e Dragash, e cilët janë të ndryshëm çdo ditë e nuk e dinë këtë çështje. Domethënë, të paktën të vendoset një shenjë e komunikacionit që ndalon parkimin, sepse e dimë që gjithë qytetin bëhet parkim i jo i mirë i qytetarëve, mirëpo në atë pjesë mundem të faktoj çdo ditë që vjen i njëjti policë me të njëjtën merimangë edhe i transporton veturat, i merr veturat. Në takimin e parë, po ju lus që ta ngritni si shqetësim të paktën të vendosen shenja e komunikacionit që e ndalon parkimi në atë pjesë. Si pyetje për drejtorinë e shërbimeve publike. Disa banorë të lagjes së Bajram Curri përkatësisht rrugës Liman Shala, kanë disa vite që bëjnë të njëjtën kërkesë për ndriçimin publik, e di që komuna e Prizrenit për momentin nuk e ka kontratën e ndriçimit, vendosjen e dritave të reja të ndriçimit publik. Mirëpo, tenderin e parë të cilën nënshkruhet nga ndonjë kompani, të jepet urdhnes që në atë lagjet të bëhen dritat sepse edhe fëmijët kur kthehen nga shkolla në orët e vona, mund të kenë në rrezik në atë rrugë. Hapja e rrugëve malore në fshatin Malësi e Vrrinit, është e disata herë që e bëj këtë kërkesë, e kam bë edhe me shkrim si kuvendar i këtij kuvendi, sepse kryetari i fshatit veçse ka dhënë dorëheqje dhe pa zgjedhjet e reja nuk ka kryetar fshati. Komuna e Dragashit e ka marrë një iniciativë prej fshatit Zgatar me fillu hapjen e rrugës deri në fshatin Malësi e Vrrinit. Mirëpo, nuk e di a ka pasur ndonjë memorandum bashkëpunimi mes dy komunave për vazhdimin e këtyre rrugëve. Siç e dimë edhe në projekt buxhetin e 2024 është edhe shtrimi me asfalt i rrugës Jeshkovë, Malësi Vërrinit e cila

edhe mund të lidhen rrugët malore me atë rrugë, edhe të bëhet lidhja me fshatrat e Opojës përkatësisht në fshatin Zgatar. Të kisha kërkuar nga ju drejtor, që të jepni një urdhëresë projektantit të komunës, që del bashkërisht me disa anëtarë të kryesisë së fshatit, edhe të bëj disa matjet rrugëve për hapje. Disa janë për mirëmbajtje, disa janë për hapje, të futen në një projekt dhe të bëhen meremetime të tyre. Një çështje të tjetër e kam për drejtorinë e bujqësisë, drejtor, deri ku ka shku puna e gjuetisë? Sepse ka shumë anëtarë që bëjnë pagesa vjetore për vend gjueti, mirëpo e dimë që gati u banën katër pesë vite që është e bllokuar gjuetia me ligj në komunën e Prizrenit. Po detyrohen me u bë anëtarë të vend gjuetive në komunën e Dragashit, për me dalë me shfrytëzuar të dielat për sport. Deri ku ka shku si procedurë? a duhet me blloku, a duhet me ritenderu apo si ka mbetur puna? Edhe një çështje tjetër për drejtorinë arsimit, shkolla 'Fadil Hisari' është në renovim, edhe nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e katërt janë transferuar në një shkollë 'Xhevat Berisha'. Ndërsa, nga klasa e pestë deri në klasën e nëntë janë transferuar në shkolla të ndryshme siç është 'Mustafa Bakiu' me gjasë dhe në shkollën tek qafa e kishës 'Lidhja e Prizrenit'. Deri kur kanë me zgjatë këto punime? A duhet të njoftohen prind se deri kur se nëse janë në një mos koordinim me drejtorin përkatës të shkollës, duhet të dinë se deri kur duhet të shkojë në shkolla të ndryshme sepse një një familje që i ka një nxënës në klasën e parë deri në 4 duhet të shkoj në të njëjtën orar të i merr në shkollë në një shkollë, një prind duhet të shkojnë në shkollën tjetër. Po e vështirëson kogja shumë për fëmijët... një muaj? okej! Faleminderit kryesuese, kërkoj falje!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Atëherë nëqoftëse nuk ka prej anëtarëve, a pate replikë Driton? E more fjalën njëherë!

Driton Daci(PDK): Deshta me u kyç tek rasti që u përmend për Krushën e Vogël. Në seancën e 14 shtatorit është votuar buxheti për vitin 2024. Në atë buxhet janë të planifikuar pesë projekte për Krushën e Vogël: njëra ndër to është objekt i ri shkollor, është ndërtimi i varrezave në fshatit Krush e Vogël, ndërtimi memorialit edhe ndërtimi përkujtimor në familjen Batusha, si dhe ndërtimi i kanalizimeve, trotuareve dhe mureve mbrojtës. Në total janë të planifikuara 500 mijë euro për Krushën e Vogël. Veç deshta me pyet Karanfilin, në këtë seancë nuk e keni votuar si subjekt politik, buxhetin, edhe thjesht nuk e keni mbështet Krushën e Vogël!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Të lutem, sa më shkurtë Karanfil, edhe po i përfundojmë diskutimet e kuvendarëve!

Karanfil Haxhillari (LVV): Unë për herë të parë po shoh kuvendarët me luajt rolin e drejtorëve! Shkarkohu o drejtor, i paskët kuvendarët që po luajnë rolin e drejtorëve. Unë, pyetjet i bëra për personat përgjegjës edhe që dy vjet qeverisje asnjë qeramidhe nuk e keni qitë! Qe dy vjet varrezat kanë mbetur qysh janë lënë, nuk ka këtu diskutim. Çka janë këto rrena koti, bollni më! Në buxhet janë të shkruar, a di çfarë keni të shkruar? Sikur edhe në raportin që keni me pa, qasi projekte i keni.!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit gjithëve për kontributin që e dhatë me këto diskutime. Atëherë, kisha propozuar që meqë jemi në prag të festave, përgjigjet besoj që pajtoheni të gjithë, ti merrni në seancën e radhës nga drejtorët. Por, në vitin e ardhshë në janar. Fillimisht le ta merr fjala drejtori, pastaj përgjigjet kryetari. Po, Kryetar!

Shaqir Totaj(Kryetar Komune): Unë edhe një herë po du me ju falenderu për të gjitha çështjet që i keni ngritur, edhe gjitha pyetjet që i keni bërë. Ata që patën aspektin ligjor, i falënderoj, ata që e patën edhe aspektin moral 2 herë, i falënderoj. Mbane këtë qasje morale, se na duhet kjo. Shumë pyetje janë bë të rëndësishme për shumë çështje po ashtu të rëndësishme. Mirëpo, duke u nisur nga fakti se fjalët janë të pa rëndësishme, të rëndësishme janë punët. Nuk vlerësohemi në bazë të fjalëve, por në bazë të punëve. Të gjitha këto çështje do t'i adresojmë përmes punëve, përmes angazhimeve konkrete. Edhe përmes angazhimeve konkrete do t'i shihni rezultatet e çështjeve të cilat i keni ngritur, ju falënderoj.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit kryetar. Atëherë në qoftë se ndonjë drejtor donë me u përgjigj, apo po e lëmë me shkrim në seancën e radhës? Po, Faruk!

Faruk Tahiri (LVV): Është e disata herë që nuk marrin përgjigje prej kryetarit, për pyetjet që ja shtrojmë kryetarit. Është mirë kryetar me këto fjalë miradije, moralizuese, të na jep përgjigje konkrete për pyetjet që bëhen, edhe të mos të na jep moral këtu se çka bën punën ky në teren apo çka s'bën në teren. Është mirë me na u përgjigj pyetjet që jemi duke i bë, na po shohim edhe çka ka në teren, edhe çka ka premtuar kryetari. Vetëm po kërkojmë që qytetarëve me ju tregu që mos lypin përgjegjësi prej kryesisë së Lirisë atje me u shkarku, se ata janë privatë, çka të donë bëjnë me klubin. Është mirë me u treguar qytetarëve këtë punë edhe kush është ai që e ka dhënë hisen më të madhe për këtë gjendje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit dikush prej drejtorëve nëqoftëse donë me u përgjigjë, në qoftë se jo, atëherë i lejmë përgjigjet me shkrim. Ju faleminderit të gjithëve, po kalojmë te pika e radhës:

Pika e Katër:

Raporti për 6 (gjashtë) mujorin e dytë të punës së Kryetarit të Komunës.

Shaqir Totaj (Kryetari i Komunës): Faleminderit, meqënëse u ndryshu rendi i ditës, atëherë po e respektojmë qashtu qysh është. Edhe po e japim një raport të përmbledhur të punës për vitin që po lejm mbas, domethënë, janar deri më dhjetor 2023. Edhe pse disa nga të dhënat nuk e përfshin komplet vitin, sepse skemi pasur me i përmbledh. Një çështje parimore, nevoja të qytetarëve edhe kërkesat e tyre janë gjithmonë më të mëdhaja sesa mundësitë tona ligjore edhe financiare. Megjithatë, përmes caktimit prioriteteve edhe përmes punëve që kemi bërë në terren, konsiderojm që kemi arrit një ngritje të vazhdueshme të performancës gjatë vitit 2023. Edhe në një masë të konsiderueshme në adresimin e çështjeve cilat janë të rëndësishme dhe cilat janë prioritetet. Pra po e mbyllim një vit të suksesshëm një rrugëtim me sfida. Meqrast, dua të ju falënderoj secilin nga ekzekutivi, po edhe nga legjislativi për përkrahje. Përmirësimi i jetës qytetarëve tanë është synimi edhe vizioni ynë kryesor. Hedhja hapave konkretë në përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës, ndërtimi hapësirave gjelbër, të hapësirave tjera publike, ka bërë që komuna të jetë më funksionale edhe më estetike po shkruan këtu në raport. Zhvillimi jetës kulturore sportive dhe artistike ka qenë po ashtu prej zotimeve tona edhe ka pasë aktivitete, ka pasur rritje të aktiviteteve, ka pasur edhe në kuantitet edhe në cilësi. Po ashtu, përsa i përket arsimit, turizmit, komunikimit proaktiv, efektivë me qytetarë, kemi pasur ngritje, kemi pasur përmirësime. Përsa i përket

transparencës dhe politikës me dyert hapura, kemi shënuar ngritjet cilësore, edhe kjo është vlerësuar nga shumë organizata joqeveritare që e bëjnë monitorimin e punës së komunës. Ni pikë e rëndësishme, ç'i mendoj që ia vlen me theksu, kemi krijuar marrëdhënie jashtëzakonisht të mira me ambasadat e shteteve perëndimore, donatorë të huaj, më shefat e agjencioneve të jashtme, me të cilët kemi zhvilluar projekte dhe kemi bashkëpunim në drejtime të ndryshme për të zhvilluar kulturën, sportin, ambientin, dhe projekte tjera të ndryshme. Kemi nënshkruar shumë memorandume me organizata të ndryshme memorandume të bashkëpunimit, të cilët na sollën projekte për rregullime në mirëqenien e qytetarëve dhe në pasurimin e vlerave tona si komunë. Në kuadër të punës në Kabinetin e Kryetarit, janë pranuar gjithsej 290 kërkesa zyrtare nga drejtoritë, qytetarët, OJQ-të, biznese, për çështje të caktuara, ku disa prej tyre janë adresuar në drejtoritë përkatëse, ndërsa pjesa tjetër janë në process. Janë publikuar të gjitha dokumentat sipas obligimeve ligjore, po ashtu, edhe janë publikuar në veb faqe zyrtare nëpër rrjetet sociale dhe në platformën e konsultimeve publike. Qytetarëve dhe palëve tjera relevante u kemi ofruar qasje të hapur në të gjitha kërkesat, vendimet dhe dokumentet komunale. Vendimet tona janë publikuar në ueb faqe, gjithashtu, vendimet me kohë janë dërguar edhe në MAPL. Vendimet publikohen edhe në gjuhën Turke dhe atë Boshnjake. Gjatë këtij viti, disa herë, nga subjektet e ndryshme institucionale dhe OJQ-të, jemi vlerësuar lartë për hapjen e dokumenteve për palët e treta dhe performancë komunale. Dje e kam pranuar raportin nga MAPL për vitin 2022, sepse për vitin 2023 tek vitin e ardhshëm fillojmë me i plotësu kërkesat edhe mundem me ju thënë se në krahasim me vitin 2021, viti 2022 ka shënuar një përmirësim mesatarisht diku 25-30%, që megjithatë konsiderojmë që është një ngritje. Po jam i sigurtë që gjatë vitit 2023 kemi pasur ngritje akoma më të madhe e cila do të pasqyrohet edhe përmes shifrave, kur të bëjmë vlerësimin e performancës për vitin 2023. Zyra për Komunikim ka publikuar të gjitha dokumentet sipas obligimeve ligjore. Qytetarëve dhe palëve tjera relevante u kemi ofruar qasje, kemi publikuar plane të rëndësishme për organizimin sa më të mirë e cilësor të punës si: plani për konsultime publike, takime dhe dëgjime publike. Kemi filluar për herë të parë buxhetimin, që është një risi dhe është pritur jashtëzakonisht mirë. Për këtë periudhë jemi vlerësuar nga palët e ndryshme institucionale. Zyra Ligjore gjatë vitit 2023 gjithsejt janë përpiluar 561 vendime dhe 34 autorizime. Zyra e Prokurimit janë nënshkruar gjithsejt 271 kontrata, prej tyre: 23 kontrata janë të vitit fiskal 2022, 13 aneks kontrata në procedurat e prokurimit të vitit 2021, 2022 dhe 2023, 258 kontrata janë të vlerave minimale, vlerave të vogla, vlerave të mesme dhe vlerave të mëdha e në të cilat përfshihen: punë, shërbime, furnizime dhe konkurse projektimi, Vlera totale e kontratave të nënshkuara për vitin fiskal 2023 është 32.7 milion euro, Vlera e parashkuar e këtyre projekteve ka qenë 40,830,613.61, Në procedurat e prokurimit për vitin fiskal 2023 janë dërguar gjithsejt 97 kërkesa për rishqyrtim, Janë ngritur në sistem 97 vendime të autoritetit kontraktues lidhur me kërkesat për rishqyrtim të OE, Në procedurat e prokurimit për vitin fiskal 2023 janë parashtruar gjithsejt 48 ankesa, për 32 është bërë zgjidhje lidhur me ankesën, ndërsa, 16 ankesa janë në proces të pritjes së vendimeve të OSHP-së për procedim të metejmë. Në periudhën Janar-Dhjetor 2023 pranë Sektorit për Çështje Pronëso- Juridike janë pranuar gjithsejt 658 lëndë, të cilat janë shqyrtuar dhe është vendosur në – 594 prej tyre në afatin e paraparë ligjor, të refuzuara – 49, ndërsa – 15 lëndë janë në procedurë e sipër. Zyra për Integritet Evropian - Implementimi i projektit ROMACTED - Këshilli i Evropës, ka qenë projekti më i rëndësishëm i kësaj zyre. Zyra e Auditimit të Brendshëm - Rezultatet kryesore/të arriturat gjatë periudhës janar – nëntor 2023 Nga shtatë (7) auditimet e planifikuara për vitin 2023, deri më 30 nëntor 2023 janë realizuar gjashtë (6) detyra audituese (raporte të përfunduara), një (1) detyrë audituese është në proces dhe sipas planifikimit pritet të realizohet gjatë muajit dhjetor, gjithashtu, është bërë monitorimi periodik lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna në këto

raporte. Zyra për Komunitete dhe kthim - Aktivitetet e ZKK-së në bazë të objektivave nga Plani i Punës 2023: Shpërndarja e druve të zjarrit për vitin 2022 ka ndodhë në mars të vitit 2023, për gjithsejt 240 familje të komuniteteve minoritare. Në bashkëpunim me DPMS-së është bërë shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike për 90 familje nga radhët e komuniteteve minoritare, prej tyre 60 pako për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, 10 për komunitetin boshnjak, 10 turk dhe 10 për komunitetin serb. Gjatë periudhës raportuese, ka pranuar 12 kërkesa për kthim. Ndërtimi i shtëpive: Sipas planit është realizuar ndërtimi i tri objekteve për familjet e të kthyerve, të cilët janë ndihmuar me projekte për biznese, mobile, dru zjarri dhe pako ushqimore dhe higjienike. Në bazë të qëndrueshmërisë së kthimit e në bashkëpunim dhe partneritet me MKK-në dhe IOM-in, kemi bërë shpërndarjen e Grantit (mini furrë) për krijimin e të ardhurave për familjen e kthyer në fshatin Mushnikovë. Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave- Këtu e dini që dy pika janë kryesore: Të hyrat dhe shpenzimet. Sa i përket të hyrave e kemi 118.50%, por nuk janë përfshirë këtu 2-3 javët e fundit. Nëpër drejtori dhe sektorë të ndyshëm kemi përqindje të ndyshme. Planifikimi Urban dhe Mjedisi kemi 170%, Ekonomi, Financë kemi 142%, e dini që të hyrat kryesore janë nga tatimi në pronë edhe nga dhënia e lejeve për ndërtim. Raporti i shpenzimeve. Sot e mora nga Sulltani raportin e shpenzimeve edhe me bë një krahasim nga viti i kaluar 2022, kemi përmirësime. Në vitin e kaluar gjithsej e kemi pasur në total 83.74% kurse sivjet e kemi në total mbi 90%. Ajo pjesë që është më e rëndësishme dhe që merret si indikator më serioz i vlerësimit të performancës, tek shpenzimet kapitale vitin e kaluar kemi qenë 62% edhe pse kam pasur dilema rreth relevancës profesionale të indikatorëve të cilët janë marrë për bazë, po sivjet i kemi shpenzimet kapitale diku tek 80%, që megjithatë është një ngritje edhe është një tregues i një pune më të mirë që është bë në vitin 2023. Te pagat normal kemi realizimin 100%, mallrat dhe shërbimet 96.32 %, shpenzimet komunale 96.48%, subvencionet 97.78%, tek shpenzimet kapitale është 80% por po du me ju informu se ndoshta nuk e dini këtë detaj, ne e kemi pasur në buxhet një vlerë prej 3 milion që është kredi në emër të projektit për efijencë elektrike, edhe kompetencat për realizimin e atij projekti për tenderim nuk janë te komuna e Prizrenit. Domethënë 3 milionshi ekziston edhe nuk na i ulë neve statistikat për 12-13%. Faktikisht pa qatë vlerë prej 3 milionëve, ne do ti kishim pasur 92-93% tek shpenzimet kapitale. Megjithatë, edhe 80% është indikator relativisht i mirë. Për sa i përket statistikave nëpër drejtori të ndyshme, ato do të kompletohen edhe do ti keni në dispozicion të gjitha, edhe pse mendoj që më e rëndësishme është performanca e treguar përmes numrave, për krejtë komunën e Prizrenit, e jo për drejtori veç e veç sepse ajo është më e rëndësishme për mua, e juve më pak ju hyn në punë. Drejtoria e Shërbimeve Publike, gjatë vitit 2023, bazuar në planifikimin buxhetor dhe planin e punës, ka paraparë një mori projektsh të reja (rreth 50 projekte), përveç atyre ekzistuese që janë në implementim - rreth 59 projekte që vazhdojnë nga vitet paraprake. Në Periudhën Janar – Dhjetor deri më tani për investime kapitale janë shpenzuar rreth 11,605,132.63€ për kategorinë ekonomike të investimeve dhe 3,272,946.70 për kategorinë mallra dhe shërbime. Disa nga projektet kapitale të realizuara gjatë vitit 2023: Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në fshatin Zhur. Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugën “Edit Durham” në Prizren projekt dyvjeçar. Asfaltim i një pjesë të rrugës “Transit i Ri”, Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në zonën nga rrethi i “Ben-Af” deri në “Ortakoll” - hekurudha (faza e dytë), Ndërtimi i rrugës transitore - kryqëzimi i rrugës transitore - kryqëzimi me autostradën në Prizren. Ka shumë projekte këtu, me i lexu bëhen shumë. Furnizimi me zhavor për rrugët e pa asfaltuara në Komunën e Prizrenit, Menaxhimi i mbeturinave, grumbullimi dhe transporti si dhe deponimi në Komunën e Prizrenit, Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen “Jeta e Re”. Po ashtu në lagjen Dardania. Drejtoria e Arsimit - Projektet kapitale të realizuara dhe në proces e sipër: Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Pllanjane"

në Pllanjanë, Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" (ish Pjetër Mazrreku) në Mazrrek, Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Krushë të Vogël, Ndërtimi i objektit të ri shkollor (9 klasa) në Gjonaj të Hasit, Ndërtimi i aneksit të objektit të objektit shkollor "Ardhmëria" në Landovicë, Ndërtimi i aneksit të shkollës në Vërmicë, Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Haziz Tola" në lagjen "Jeta e Re", Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Fatmir Berisha" në lagjen "Bajram Curri", Ndërimi i dyerve dhe dritareve të shkollës "Fatmir Berisha" në Prizren, Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme në Romajë – Has, Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor "Gërmaqare" - Novoselan, Ndërimi i kalldajave të ngrohjes qendrore në: "Mustafa Bakia" dhe të tjerat të cilat i keni në raport. Deri në fund të vitit 2023 realizimi i punimeve nga planifikimi, pritet të jetë rreth 98 % . Gjatë vitit 2023 janë realizuar edhe tri projekte të tjera (nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime) si më poshtë: Renovimi i tërësishëm i sallës së edukatës fizike të shkollës "Emin Duraku" në Prizren edhe Renovimi i kulmit të objektit shkollor "Dëshmorët e Hasit" në Fshatin Kabash edhe Fshatin Skorobisht, po ashtu. Të gjitha punimet janë realizuar dhe brenda muajit dhjetor do të kryhet edhe pranimiti teknik. Dejtoria e Administratës - Sektori për mbështetje dhe logjistikë: Punët kryesore të sektorit: Renovimi i Qendrës së Sindrom Down, Renovimi i zyrave të Kadastrit, Përfundimi i punimeve në teracat e objektit të Komunës, Riparimi i rethojave para administratës, Mbështetja e organizimit të Epopesë së Gorozhupit, Zëvendësimi i ndriçimit në Sallën e Asamblesë, Kemi furnizuar me dru dhe pelet të gjitha objektet nën mbikqyrjen tonë, Kemi rregulluar parkun para Administratës Komunale me mbjelljen e luleve, Mbështetja dhe organizimi i festivaleve si dhe vendosja e flamujve në lapidare në qytet, e shumë e shumë projekte të tjera. Një projekt që harrova me cekë, është rregullimi i trotuareve me këto kupëzat rreth qendrës historike, që ka marrë vëmendje të qytetarëve dhe ka pasur komente pozitive. Drejtoria e Shëndetësisë - Mbështetja financiare e personave të sëmurë me CA, Tumore, puntorët e administratës komunale me sëmundje të rënda si dhe fëmijët deri në 18 vjeç me sëmundje metabolike, paralizë cerebrale, diabet insulinvariantës. Tek investimet kapitale: Furnizim me paisje stomatologjike, Furnizim me paisje laboratorike, Furnizim me Autoambulanca, Ndërtimi i QMF në fshatin Korishë, Ndërtimi i QKMF në ITP, Ndërtimi i aneksit të QMF-së në fshatin Gjonaj, Zhur, Reçanë, Dardania, Digjitalizimi i shërbimeve të urgjencës në procedurë tenderuese. Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale ka pasur këto projektet kapitale: Fillimi i ndërtimit të sallës për rekreacione sportive të shtëpia me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuara, Fillimi i rregullimit të infrastrukturës së jashtme të objektit të shtëpisë së pleqve, Fillimi i ndërtimit të qendrës së re sociale, Projektimi i parkut rekreativ të shtëpia me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuara, Hartimi dhe përpilimi i projekteve të reja dhe projektimi i renovimit të projekteve ekzistuese. Strategjitë dhe programet komunale: Programi tre vjeçar për banim 2023-2026. Strategjia komunale për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Prizrenit. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës në Komunën e Prizrenit. Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillit Rural: Investimet kapitale ka pasur: Rehabilitimi i kanaleve ujitëse, Rehabilitimi i rrugëve fushore, Ndërtimi i strehimores për qentë endacak. Projektet me bashkëfinancim: Ngritja e serrave – 40 përfitues/fermerë, Ngritja e pemishteve me pemë të imta, Ngritja e pemishteve me pemë arra – 20 përfitues/fermerë, Furnizimi me mekanizma bujqësore – 251 përfitues/fermerë. Tek Subvencionet kemi: Subvencionimi i sektorit të bletarisë – 115 përfitues, Subvencionimi i aquakulturës – 1 përfitues, Subvencionimi i qumështit – 77 përfitues, Subvencionimi i deleve dhe dhive – 120 përfitues, Subvencionimi i sektorit të shpendarëve – 3 përfitues, Ndërrimi i folies për serra – 78 përfitues. Tek Mallëra dhe shërbime: Insemenimi artificial i lopëve, vaksinimi i deleve, Trajtimi i qenve endacak, DDD i qytetit dhe zonat periferike, Pjelloria e tokës, Vaksinimi i qenve kundër tërbimit, Vaksinimi i deleve kundër brucelozës, Hartimi i projekteve për fermerë – grant. Drejtoria

e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka pas shumë projekte, po i përmendi disa: Renovimi i Shtëpisë së Kulturës "Xhemajli Berisha" në Prizren, i cili pritet të rihapet në pranverë. Renovimi i sallës sportive në Romajë, Përrurimi i Qendrës Sportive "Sezai Surroi" pas renovimit të tërësishëm. Stadiumi në Gjonaj – Has. Fillimi i fazës së dytë dhe perfundimtare në stadiumin e Zhurit, Gurthemeli i kullës "Remzi Ademaj" në Zhur. Inventarizimi në qendrën sportive drejt finalizimit. Ndërtimi i hapësirave të varrezave të martirëve në Landovicë. Ka përfunduar ndërtimi i fushës së re sportive në shkollën "Dëshmorët e Kabashit" në Korishë. Ridizajnimi dhe finalizimi i projektit të Qendrës Rinore në lagjen "Ortakoll". Punimet e murit mbrojtës në stadiumin e Zhurit. Përrurimi i shtatores së Dëshmorit "Agim Shala". Punimet e Sallës Multifunkionale. Tek Subvencionet, kemi pas dy thirrje. Thirrja e parë: 1.1 milion. Thirrja e dytë 0.4. Në total 1.5 milion euro. Domethënë është një trefishim i subvencionimit të organizatave në fushën e rinisë, kulturës, sportit, krahasuar me periudhat e mëhershme. Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik - Projektet kryesore infrastrukturore të cilat janë pjesë e investimeve kapitale janë: Ndërtimi i infrastrukturës në Parkun Ekonomik në Lubizhdë. Ndërtimi i shtigjeve për biçiklista (Cvilen, Vlashnje). Ndërtimi i infrastrukturës së turizmit malor dhe rural - Nashec, Jabllanicë, Vërmicë. Ndërtimi i infrastrukturës (rrugët dhe ambienti) turizmi kulturor. Ndërtimi (rrugë, kanalizim, ambient) - Poslisht, Nashec, Struzhë, Kabashë, Landovicë. Hapja e rrugëve malore (Kala - Pashaqeshme, Zhur, Kapanavodë, Vërmicë). Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Poslisht, Struzhë, Kabash dhe Korishë. Drejtoria sa i përket projekteve kapitale ka bërë: Ndërtimi i infrastrukturës në Parkun Ekonomik. Ndërtimi i shtigjeve për Biçiklistë. Ndërtimi i infrastrukturës së turizmit malor dhe rural Ndërtimi i infrastrukturës (rrugët dhe ambienti) turizmi kulturor - Hapja e rrugëve malore. Subvencionet ka pas në vlerën rreth 90.000 euro, me 8 përfitues. Projekte të tjera të realizuara është "Ringjallja e Zejeve dhe Ndërtimi i Kulturës për Zhvillimin e Përbashkët Turistik". Te ringjallja e zejeve e kemi fjalën për organizimi e dy trajnimve për ruajtjen e zejes së Filigranit, sepse kemi konsideru që është një element identifikues i qytetit të Prizrenit. Drejtoria e Inspektorateve - Sektori i Ndërtimit, Kontrollimi i terrenit: Ndërrprerja e ndërtimeve pa leje si: objekte afariste, banim kolektiv, shtëpi banimi, depo, objekte të karakterit të përkohshëm, kiosqe etj. Kontrollimi sistematik i objekteve me leje si: objekte afariste, banim kolektiv, shtëpi banimi, depo, objekte të karakterit të përkohshëm, kiosqe etj. Rrënimi i objekteve: Është bërë rrënimi i objektit shtëpi individuale për banim në lagjen "Arbanë". Është bërë rrënimi i shkollës në fshatin "Velezhë". Demolimi /gërryerja e një shtrese të betonit e shtruar në një segment të rrugës pa leje nga organi kompetent në "Pasha Çeshme". Rrënimi i mbindërtimit të objektit banim kolektiv në lagjen "Ortakoll". Demolimi/rrënimi i objekteve me karakter të përkohshëm, konstruksionet metalike/druri etj., të ndërtuara pa lej. Ekzekutimi ka filluar në lagjen "Ortakoll", ëshë fjala për lirimimin e hapësirave publike nga këto konstruksionet metalike. Sektori i Tregut-Aktivitetet e realizuara: Ka shumë këtu, do ceken disa: Inspektimi i bizneseve, Inspektimi i mjeteve matëse, Inspektimi i bizneseve autoriparuese (autoserviseve), Inspektimi i kiosqeve, Inspektimi i bizneseve brenda ish kampit të KFOR-it Gjerman, Inspektimi i sallave të dasmave, Inspektimi i restoranteve, gjelltove, qebaptove, byrektoreve, ëmbëltoreve, lokaleve me ushqim të shpejtë (fast food). Inspektimi i rrobaqepësive, Inspektimi i frizereve, Drushitësit, Inspektimi i lokaleve afër shkollave. Inspektori i komunikacionit në kuadër të kompetencave ligjore ka bërë inspektime të rregullta. Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri- Kemi këto projektet e realizuara: Është realizuar projekti për Fizibilitetin e Kamerave të Sigurisë, mirëpo për fat të mirë jo tonin, tenderi nuk pat sukses për herë të dytë. Është shpallur tenderi për "Vendosjen dhe mirëmbajtjen e kamerave të sigurisë". Është nëshkruar kontrata për "Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera. Është realizuar projekti për blerjen e Automjetit Sulmues për

Brigadën e Zjarrfikësve. Ëshë pranuar donacion një automjet me shkallë, me lartësi prej 30m nga komuna e Bingenit që kemi binjakëzim mbi 50 vjet. Është realizuar projekti për furnizim me radiolidhje për Shërbimin e zjarrfikësve. Është realizuar “Dita e zjarrfikësve”, më 25 Qershor.Ndërtimi i mureve mbrojtëse. Është realizuar fushata vetëdijesuese për qytetarët. Janë mbajtur ligjerata nëpër shkolla nga Shërbimi i zjarrfikësve. Është nënshkruar kontrata për servisimin e automjeteve. Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, ka pasur këo aktivitete: Renovimi i objekteve me vlerë historike-kulturore. Rehabilitimi i kulmeve në objektet e banimit kolektiv. Kemi marrë vendimin për hartimin e planit rregullues urban për zonën e veçantë - Parku i Biznesit. Rregullimi dhe rehabilitimi i korridoreve (lyerja) në objektet e banimit kolektiv. Kemi themeluar zyrën për legalizim dhe kemi rekrutuar një staf për trajtimin e objekteve pa leje në bazë të ligjit. Normal Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, ka punë të rregulltë edhe dhënien e lejeve, ajo nënkuptohet. Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë Aktivitetet më të rëndësishme që janë zhvilluar në këtë periudhë janë: Legalizimi: Janë regjistruar 564 vendime të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor sipas ligjit për ndërtimet pa leje. Shpronësimet: Gjatë afatit raportues janë përpiluar elaboratet për shpronësim dhe janë dërguar në Qeveri për aprovim sipas ligjeve në fuqi. Ndër projektet më të rëndësishme janë:Varrezat e Qytetit - ku për shkak të hapësirës e cila është zënë në qytet, është aprovuar nga ana Qeverisë kthimi i pronës, edhe jemi në fazën e fundit ku neve na duhet tash vetëm të marrim fakturën edhe të fillojmë me përdorë atë parcelë atje tek Transiti, për zhvendosjen e Varrezave. Unë e pata një raport pak më të shkurtuar, më të përmbledhur sepse me pas lexu të gjitha detalet ish bë tepër dhe skish pas edhe interesim. Po sidoqoftë ju keni me pas në dispozicion raportin e tërësishëm, edhe aty keni pa mënyrën më specifike edhe më detalizuar. Po ajo që është e rëndësishme, perfeksionizëm nuk ka, po ajo që është e rëndësishme është një trend i ngritjes së vazhdueshme të performancës i cili jam i sigurt se do të vazhdon edhe vitin e ardhshëm. Ju falenderoj për vëmendjen!

Karanfil Haxhillari (LVV): Rregullorja e thotë që kur është pika e rendit të ditës, minimum 5 minuta i ke. Faleminderit kryesuese, kuvendar të nderuar të asamblesë komunale, media, qytetarë të nderuar të Prizrenit. Paraprakisht, neve këtu si pikë e rendit të ditës, na është ofruar, thotë raporti për gjashtë mujorin e dytë të punës së kryetarit të komunës. Kurse në material, e kem raporti i punës kryetarit janar-dhjetor 2023. Përcaktohuni o njerëz, a për gjashtë muaj, a për një vjet e keni bërë raportim. Dua me u ndalë në vetëm disa gjëra, të cilat, sepse është kopje paste, si raporti i vitit kaluar, fontonë dëshirash. Po dua me u ndalë ekskluzivisht në disa çështje që shumë më bënë përshtypje. Fillimi thotë: po e përmbylim edhe një vit të suksesshëm, një rrugëtim me sfida e kënaqësi. Po kryetar, jeni kënaqur, kjo është shumë e vërtetë. Pastaj thotë: përmirësimi i jetës së qytetarëve, veç ta kisha ditur çfarë përmirësime keni bërë në jetën e qytetarëve.?! Thotë ndërtimi i hapësirave të gjelbërta dhe hapësira të lira publike. Me më pas kallëzu ku janë hapësirat e gjelbërta ishte kon mirë. Zhvillimi i jetës kulturore, sportive dhe artistike, po e zhvillojmë sportin duke e ngritur nivelin e ekipeve të qytetit. Allahile seriozisht e ke kryetar a? Ku i ke ekipet e qytetit o kryetar? Në fund të pusit! Lirinë tash më e ke as mish as peshk, nuk dihet a është Ojq, a është Shpk apo çfarë është. Bashkimin po ashtu dhe knejna thotë: i kemi ngritur nivelin e tyre. Një ndër punë kryesore, thotë, të qeverisë sonë është transparenca dhe politika e dyerve të hapura: Për cilat dyer të hapura, kush çdo derë është me sigurim, me ka dy sigurime si në kuvend poshtë, si në shtëpinë e bardhë, a janë këto dyer të hapura? E pashë një mori memorandumesh bashkëpunime, një mëri bashkëpunimesh, por nuk arrita të kuptojë sa është përfitimi i komunës së Prizrenit, sa të hyra i ka nga këto memorandume dhe nga këto bashkëpunime? Derisa kishte dhe do memorandume, me të vërtet, a dinë shumë qesharake. E kishin përmend edhe kontratën për

dhënien shfrytëzim pronës mes komunës Prizrenit dhe Kamiles, thotë, a dinë! Po këta e ka bë asambleja o kryetar! Por, sido që të jetë. Te zyra për komunikim thotë: u kemi ofruar qasje të hapur në të gjitha kërkesat, vendimet dhe dokumentet komunale. Po mos të ishte agjensioni për informim dhe privatësi, e kishim pa sa kishim pasur transparencë dhe qasje në dokumente. Është, po kalojmë në projekte të drejtorisë. A keni bërë raport për kodet buxhetore të cilët i keni? Apo për punë të cilët i keni kryer? Nuk po muj me kuptu, raporti i punës bëhet atëherë kur puna një projekt përfundon. Pra, e kemi përfunduar këtë projekt. Shembull, thotë: ndërtimi i rrugës tranzitore kryqëzimi rrugës tranzitë kryqëzim me autostradën, këtu thotë ndërtimi domethënë projekti përfundum, në anën tjetër drejtori thotë “jo shtresa parë, jo shtresa dytë edhe pse u dëmtu disa herë”, tash a është përfundu ai projekt a jo? Ku edhe ka pasur edhe përrurim aty, që kemi parë të gjithë qytetarët. Ndërtimi i katër parqeve: unë jam qërru, o nuk e di ku janë këto katër parqe! Në qoftë se mendoni “mbjellja e katër pishave” te emergjenca me 15 drona dhe 12 fotografë, atëherë në rregull është. Po katër parqe ku i keni ndërtu unë s'pe di! Ndërtimi infrastrukturës në lagjen Bajram Curr në Prizren, po shpresoj që është ajo rruga që zgjati me muaj të tërë dhe në paramasa komplet vlera tjera, kurse në realitet me komplet vlera tjera. Drejtorinë arsimit, në arsimit të merr të merr mendja që je duke e shikuar drejtorinë e shërbime publike, ndërtime, ndërtime! Thotë një prej këtyre, fillimi i proceseve të digjitalizimit të shkollave. Mirë që paskët fillu më në fund a din. Por, kur e përmendni edhe memorandum bashkëpunimi me Flutra akademi, kjo të lenë shumë për të dëshiruar. Po ashtu, këtu e keni paraqitet si një prej tyre thotë edhe ndërtimin e çerdhes në lagjen të Tusus. Shumë është interesante, a keni hedh gur themel, a e keni ndërtuar apo? Pra, të gjitha projektet, shumica e projekteve janë fillimi kurse këtu në paraqitet neve në raportin e punës si projekte pothuajse të përfunduara. Drejtoria e shëndetësisë, e përmenda dhe pak më herët, në qoftë se i shohim raportin, vetëm raportin e drejtorisë së shëndetësisë të lenë shumë për të dëshiruar. Edhe shumë thjesht është, në raport në procedurë tenderuese, në proces të realizimit, procedurë tenderuese, në proces të realizimit, e realizuar diku, pezulluar. Me të vërtetë, raporti është i tmerrshëm. Po, edhe pak më herët e pata paramendo mos me funksionu në një Amfë, mos me pas vaksinim për fëmijët e gjerë është e tmerrshme kjo. Por, a di çka kishte të mirë kjo drejtori, i kishte manifestuar gjitha ditët botërore, i kish kryer ditët botërore, i kish përfunduar. Drejtoria e punës dhe mirëqenies sociale - në këtë raport, në bazë të këtij raporti, drejtor, duhet me të thotë urime fillimi i qeverisjes, sepse të gjithë raporti është fillimi i ndërtimit të sallës, fillimi i rregullimit të infrastrukturës, fillimi i ndërtimit të qendrës. Domethënë, të gjitha i ka fillime, urime fillimi i qeverisjes për ty, drejtor, pas dy vjetësh. Po ashtu, nëqoftëse e shohim me hollësi memorandumet e bashkëpunimeve të cilat i kishte kjo drejtori, edhe punës që i kishte bërë kjo drejtori, të jep me kuptu shumë interesant që si punë të veta i paska qitë edhe shpërndarjen e pakove dhe të ndihmave të Ambasadës së Emirateve të Bashkuara, Ojq Bereqeti, Islamik, Jetimat e Ballkanit, që i bjen që organizatat humanitare paskan bërë shumë më shumë punë për mirëqenien sociale se sa kjo drejtori. Drejtoria e kulturës, e rinisë dhe sportit - po besoj që me të vërtetë që shumë të le për të dëshiruar. Por, të gjitha projektet bre shumë interesantë nuk po ju zgjasin as një muaj, as dy! Është me të vërtetë e tmerrshme! Edhe këtu, sot përrurohet fitnese, çka po di unë e parku për fëmijë, nuk kalojnë tri ditë, veç i sheh ishin ndërtu ato me shtrafa nënçe, as fotografitë nuk i barin ato shtrafa. Drejtoria e turizmit dhe zhvillimit ekonomik - Okej, kjo objektivat perfekte i kishte kjo drejtori, për objektiva, por realizimet në qoftë se i kthejmë, me të vërtetë lenë për të dëshiruar. Tash thotë ndërtimi i rrugës në Struzhë, ose në qoftë se ka ndonjë Struzhë tjetër, a dinë, bon vaki, se këto projekte që janë përmendur në Struzhë nuk i kam parë unë. Jo, jo, çdo fundjavë shkoj, çdo fundjavë shkoj në Struzhë. E kurse në Krushë është diçka e pame.. Edhe shtigjet e çiklistëve u përmendën disa. Këto janë planifikime, por ama që nuk është bërë asnjë lëvizje sa i përket

drejtorisë së turizmit, si në aspektin e zhvillimit të turizmit malor, po si edhe tjetrën, kjo nuk ka koment. Po, si punë e kanë paraqitur pjesëmarrjen në panahire të mbajtura në Shtutgard dhe në Esen të Gjermanisë. Te drejtorja e inspektorja, - urime drejtor, një shtëpi brenda një viti e paske rrënu. Rrënimi i objekteve thotë vetëm një. Tash kadale, tash të dalë këtu... More unë thash urime rrënimi mban fund për dy vjet një shtëpi e paske rrënuar. Nuk thashë keq, nuk ofendova! Po ashtu, koka edhe rrënimi i mbindërtimit në Ortakollë, me atë të cilën e patëm... Jo, kjo është rrënimi i mbindërtimit, jo objektit. Edhe keni shkruar raportin dhe nuk po e dini. E kishit paraqit edhe asistimet e policisë domethënë me dhjetëra asistime të policisë në inspektime. Në rregull, po ato janë punë të... Kalojmë te drejtorja e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor - thotë renovimi i objekteve me vlerë historike kulturore. Kemi arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Qrtk-në, restorimi i objektit të ish-Arkivit Komunal dhe me këto investime, thotë, po mundohemi me ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Është diskrepancë e pa parë në raport me atë që po e thonë, edhe me atë që i kanë realizuar. Ishin përzgjedhur disa objekte, domethënë, i paskan siguruar disa kushte për punë, edhe këtu 0 është. Ky raport i punës së kryetarit, nuk është raporti punës po është raporti i mos punës. Është raporti i cili nëqoftëse qytetari e lexon me vëmendje e sheh seriozitetin e kësaj qeverisje, që s'është hiq serioze dhe të vërtetë është një raport tallës për qytetarë të komunës së Prizrenit, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, zotri Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Kryesuese, kam një propozim: është tu u debatuar për raportin kryetarit dhe kryetarit nuk është këtu. Po ju lus, jashtë është një grumbull qytetar që po protestojnë, është mirë me ndërpre seancën derisa ata gjinden në oborrin e shtëpisë bardhë. Përndryshe, duhet të kthehet kryetari dhe rreth raportit kryetarit bisedojmë sa është kryetari këtu. Unë, unë e di që aj u thirr tash atje me me kontaktuar me qytetarët... po e ka një delegacion jashtë.. Nuk e di, ma mori mendja, është mirë me ndërpre seancën deri sa të kryehet qajo protestë, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Nënkryetari fjalën.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Kryesuese, kryetari është këtu, është takim me protestë edhe pse padrejtësisht bëhet para shpisë së bardhë se është adresu diku tjetër. Megjithatë, jemi këtu tjerët, janë drejtorët, jam unë, nëse mendoni që duhet me u mbajtur, nëse jo mundeni me kalu në pika tjera, derisa të kthehet kryetari.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po kalojmë pikën tjetër edhe pak, mandej na kthehet kryetari edhe kthehemi, meqënëse po e doni prezentë kryetarin. Mirë kështu tash renditja është shqyrtimi dhe miratimi propozim rregullores.....

Dafina Alishani (LVV): Kryesuese, a mundeni me na informu kur kthehet kryetari. A dihet termini i takimit? Po mirë bre nënkryetar a mundesh ti mos me u përzi? Me kryesuesen po flas. Po mandatin e kalum se keni lënë nënkryetarin asnjë fjalë me thënë, tash po duhet veç me juve me repliku nënkryetar.! Rendi i ditës është raporti kryetarit të komunës! Nuk ka kuptim nëse na bëjmë këtu kritika ose bëjnë pyetje, kryetarin mos me pas këtu. Ju lutem informoni nga administrata kur kthehet kryetari, kaq!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Atëherë, derisa të kthehet kryetari po kalojmë ne te pika e radhës. Po pse kjo raport nuk është që kemi me votu diçka. Momentin kur vjen kryetari, kalojmë pastaj tek kjo pika, që shkuan me u interesu kur kthehet kryetari dhe ju japni përgjigje. Po kalojmë tek pika e radhës. Po herët është pak Dafina, unë edhe për shkakun e juaj e kam që edhe ta përfundojë më herët kështu, që shkojmë.

Pika e Pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim rregullore komunale për kushtet kriteret dhe procedurat ndarjes së subvencioneve transfereve dhe granteve.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Nënkryetari i fjalën e ka.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Faleminderit e nderuara Kryesuese, të nderuar anëtarë të kuvendit, koleg nga ekzekutivi, të nderuar përfaqësues të mediave. Më lejoni të jem i shkurtë edhe të prezantojë para jush rregulloren e cila përcakton kushtet kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës Prizrenit ndarjen e mjete financiare nga kategoria subvencioneve dhe transfereve për fushat e caktuara në këtë rregullore për personat fizikë dhe juridikë mbi bazën e kërkesës së tyre ose mbi bazë të thirrjes publike. Gjithashtu, për ndarjen e granteve si dhe vendosjen e një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin dhe subvencionimin e projekteve aktiviteteve dhe dhënies së ndihmës për nevoja të ndryshme për personat fizikë dhe juridik apo edhe për programat që realizohen në komunën e Prizrenit. Komuna ndanë subvencionin në bazë të kësaj rregulloreje për transfere dhe gradë në këto fusha: arsim, kulturë, rini, sport, turizëm, zhvillim ekonomik, bujqësi, shëndetësi, rastet sociale, në fushën e mjedisit, fatkeqësive nga zjarri dhe fatkeqësive natyrore. Subvencione për rradhët e komuniteteve jo shumicë, për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut si dhe duke mos u kufizuar dhe në fushat tjera si programeve të start up-ve, programeve të cilat kanë interes për qytetarët dhe komunitetin për të cilat edhe është i përcaktuar projekti ose programi. Kjo rregullore përfundimisht vendosë rregulla strikte të ndarjes së subvencioneve nga komuna, vendos kontroll ligjor dhe përcakton proces të qartë të shpërndarjes së subvencioneve sipas prioriteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorive përkatëse dhe sipas nevojave më të mëdha të cilat adresohen në komunë. Ky dokument është i bazuar në ligjet përkatëse financiare dhe në rregulloren e Ministrisë së Financave 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve. Gjithashtu është e bazuar në shumë rregullore tjera të avancuara të cilat rregullojnë mënyrën e ndarjes së subvencioneve për ajo çka do të veçoja tani, rregullorja ka marrë për bazë për herë të parë shumë raporte të auditimit gjatë hartimit të dokumentit. Të nderuar anëtar të kuvendit unë do të jem i gatshëm për mos me zgjatë më shumë, do të përgjigjem edhe në diskutime ose të japë shpjegime nëse ka nevojë meqë e kemi bërë këtë proces prej zyrës së kryetarit dhe në të njëjtën kohë më lejoni të ju ftoj me dhënë rekomandime sugjerime por edhe nëse keni ndonjë vërejtje. Gjithashtu në fund po du me falenderu edhe komisionin që ka bërë një punë të jashtëzakonshme i cili ka qenë i përbërë prej shumicës së drejtorive që kanë subvencione dhe të njëjtën kohë përfaqësuesin e OJQ-së EC MA NDRYSHE, që ka qenë pjesë e këtij komisioni. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Nënkryetar. Kush dëshiron fjalën rreth kësaj pike më e marrë? Po, urdhëro Selman.

Selman Sokoli (LVV): Faleminderit Kryesuese. Kjo rregullore përveç disa lëshimeve që kishin mundur me qenë më mirë te transparenca, te llogaridhënia edhe te eliminimi i mundësisë për konflikt të interesit. Ka edhe disa gjana që po mendojmë që si Lëvizje Vetëvendosje mi propozu edhe e kishin përmirësuar si rregullore. Unë do t'i prezantoj në emër të grupit të asambleistëve të Lëvizjes Vetëvendosje 2 amendamente: Njëra ka të bëjë me bujqësinë, njëra ka të bëjë me subvencionet për fëmijët dhe nënat lehona. Amendamenti për bujqësi ka t'bëjë me pajisjet bujqësore, d.m.th. aty që aplikues për pajisje bujqësore mund të jetë ai bujk i cili nuk ka përfituar në tri vitet e fundit, për shkak se mekanizmi bujqësor llogaritet që nuk është i vjetërshëm shpejt ato që i jep komuna. Domethënë ky është amendamenti i parë. Mundem me ja dorëzuar Kryesuese administratës për më pas ma lehtë, i kemi të shkruara. Edhe amendamenti dytë ka t' bëjë me për subvencione për fëmijët e posalindur. Tash mundemi me i dhënë këto subvencione përmes vendimeve të kryetarit, mirëpo 1 vit jipen, 1 vit nuk jipen, gjenden arsytetime të ndryshme. E kemi një mundësi që përmes rregullores disa komuna e kanë rregulluar, disa komuna në nivel të Kosovës, pa dallim partie. Edhe ne këtu në Prizren e kemi një mundësi që përmes këtij amendamenti, përmes kësaj rregullore me bë përmes ligjit, përmes rregullores që nxjerr kuvendi, dhënien e shtesave dhe subvencione për fëmijët. Unë do ta lexoj edhe tani si tekst ja ofrojë administratës, domethënë subvencione për fëmijët e posalindur. Për të aplikuar për subvencione për fëmijët të posalindur, prindërit aplikues duhet të plotësojnë këto kritere: të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, të jenë banorë të Komunës së Prizrenit. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për fëmijët të posalindur janë: dokument identifikimi valid, ekstrati i lindjes së fëmijës, deklaratën e bashkisë familjare, konfirmimi i llogarisë bankare të njërit prind. Subvencionimi për fëmijët e posalindur, tash jemi të shumta e subvencionimit, sipas propozimit tonë do të jetë kështu: për fëmijën e parë 250 euro, për fëmijën e dytë 300€ subvencion, ndërsa për fëmijën e tretë e tutje 350€ subvencion. Tash për ta rregullu një kohë se kjo nuk mund të jetë kështu pafundësisht, e kemi paraparë që pagesa për çdo fëmijë të lindur individualisht dhe aplikimi domethënë pagesa dhe aplikimi zgjatë tre muaj nga dita e lindjes. Domethënë çdo prind 3 muaj, deri në 3 muaj nga dita e lindjes së fëmijut të tij mund të aplikojë në komunë dhe ti përfitojë këto subvencione në bazë të rregullores. Për këtë ftoj të gjithë asambleistët, sidomos asamblesistet pa dallim, që të miratojmë edhe ta rregullojmë këtë çështje me rregullore dhe kjo do të jetë afatgjatë, nuk do të varet më kush do të jetë Kryetar i Komunës. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit. po urdhëro Nënkryetar.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Sa i përket 2 propozimeve. E para te bujqësia është e definuar që mrena vitit nuk mund me marrë dy herë me përfitu nga subvencionet dhe janë të përcaktuar në mënyrë të detajuar. Ndërkohë sa i përket pajisje bujqësore nëse aplikanti ka marrë edhe nuk duhet me marrë tre vitet e ardhshme, besoj varet për llojin e pajisjes. Unë për pajtoja që për të njëjtën pajisje nëse themi gollidon ani nuk mundet me marrë vitin e ardhshëm prap gollidon, është e qartë kjo punë edhe kjo aplikohet në drejtorinë përkatëse. Kurse sa i përket fëmijët posalindur e kemi te nenin 29 pika 1.1 mbështetje financiare për nënat lehona, domethënë është pika e parë edhe kjo çështje është rregulluar njëherë e përgjithmonë me këtë rregullore, nuk ka më thirrje publike për aplikim për nënat lehona, këto me automatizëm do të jenë të përfituese. Kurse sa i përket vlerave kjo smundet mu përcaktu në rregullore, rregullorja përcakton procedurën e

vlerat përcaktohen me vendim të kryetarit, varësisht sa ka mjete të planifikume në drejtorinë përkatëse edhe varësisht sa është numri i të lindurve brenda vitit. Po pajtohen që pagesa duhet të jetë brenda një afati tremujor, por për rastin konkret, të përcaktume në këtë rregullore tek pika 1.1. Kjo mund të ndodhë edhe brenda muajit nëse mjetet janë të sigurume nga drejtoria përkatëse. Nuk kisha me thënë që duhet me vendos afate për faktin se ti mundesh mos me pas subvencione 6 muaj, nëse s'ke pas të hyra, po flasim për naj rast ma të veçantë. Përndryshe këto janë mjete të planifikuara në drejtojnë përkatëse, tash nuk do të ketë më nevojë për zhvillim procedurash sepse nënat lehona do të përfitojnë me automatizëm në momentin e lindjes së fëmijës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po Selman, urdhëro.

Selman Sokoli (LVV): Mbështetje, domethënë drejtoria subvencionet dhe transfertat në fushën e mirëqenies sociale. Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale ndanë ndihmë financiare subvencione dhe transfere nga buxheti i saj për këto kategori por pa u kufizuar. Mbështetje financiare për nënat lehona. Më fal, po flasim për rregullore në nivel të komunës, në nivel qendror kishte me qenë ligj edhe duhet të jetë e përcaktuar qartë, koncize edhe saktë çka po kërkohet. Për shkak se kjo nuk është definume, ne, siç e thashë e propozum një amendament, se 1 vit në këtë qeverisje s'kemi pasur shtesat edhe gjithmonë ky arsytimi nuk ka mjete, veç një rrugë malore nëse hyjmë në atë farë diskutimi e lënë anash që nuk i ke patjetër edhe i gjan mjetet. Një llogari domethënë shuma konservative dhe shuma më e lartë sa e kemi bë për afërsisht është 500.000.00 deri në 700.000.00 euro në vit. Mirëpo, kjo nuk ka matje në bazë të atyre që kuptojnë statistika, kjo mundet me kanë matja më e saktë domethënë 500.000.00 euro kufiri poshtëm, 700.000.00 euro, kufiri i lartë. Mbështetje financiare për nënat lehona nuk e rregullon, amendamenti ynë e rregullon në periudhë afatgjatë edhe nuk ja len në diskrecion asnjë kryetari, pa më parasysh cili do të jetë ai. Por është në rregullore komunale. Siç e dini kjo rregullore është hartuar në 2013, është amendamentuar në 2020, edhe po e rishkruajmë prapë në fund të 2023-tës. Kështu që, ne nëse pajtohemi që ta fusim këtë amendament normal gjithsesi do të dalë në votim. Por nëse votojmë të gjithë, prapë po them sidomos i kisha ftuar edhe asambleistet gra, për shkak se do ta kenë të rregulluar për një periudhë afatgjatë çështjen e shtesave për fëmijë përmes një rregullore të veçantë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Selman. Nënkryetari e ka fjalën.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Faleminderit Kryesuese. Përkundër që s'po e kam shumë të qartë tash çka po kërkohet konkretisht se atë që po e thotë asambleisti është nenin 30 te dokumentet e nevojshme për aplikim. Pika 1 te dokumentet e nevojshme për aplikim për subvencione në këtë drejtori pa thirrje publike gjithmonë po flas sepse e ki mrena thonjzave pa thirrje publike ku përfshin këto dokumente: kërkesën e palës, dokumenti valid, ekstratin e lindjes, certifikata e deklaratës, konfirmimi bankës dhe xhirollogaria bankare të përfituesit këtë rast prindit, certifikata e vendbanimit, dëshmi të gjendjes civile që e konfirmonë lidhjen familjare, dëshmia-kartoni i skemës sociale për ato rastet tjera që janë sociale, pra janë të definuara. Megjithatë unë të kisha ftu me shkrim me dorëzuar në administratë dhe na kemi me harmonizuar me nenin përkatës, nuk ka kurgjo të keqe. Megjithëse janë, vlera nuk mundet në rregullore mu shkru financiare.

Selman Sokoli (LVV): Kryesuese edhe njëherë për mu sqaru. Amendamenti e rregullon qartë, në mënyrë të përhershme nuk varet nga vendimi i asnjë kryetari, për shkak se është rregullore e

Kuvendit Komunal edhe e rregullon qartë. Te shifra, te shuma është çështje tjetër, kjo është propozimi ynë. Mirëpo amendamenti këtë rregullore e plotëson te shtesat për nënat lehona. Është trend në Kosovë, mirë që është trend se ne duhet ta krijojmë një një pod, një bazament të mirëqenies së qytetarëve, e tani në bazë të suksesit të tyre ata të mos kenë kufi në arritjet e tyre. Mirëpo, kjo ja siguron njëfarë podi, njëfarë të mirëqenies së qytetarëve. Edhe ne prap po e tham nuk ka të bëjë me kriteret, se kjo është në kuadër të amendamentit. Mirëpo me rregullore për me qenë nënkryetar shumë i qartë, me rregullore po kërkojmë me rregullu, jo me vendim të kryetarit, është dallim i madh. E kanë bërë disa komuna, s'ka rëndësi cilat subjekte, m'doket ka nga të gjitha partitë. Kështu që, unë po them që në nenin përkatës i futet kjo pikë, kjo fillon pika 1 deri te pika 1.4, edhe vazhdojnë tutje. Besoj nuk ka kurrjë të keqe edhe e obligojmë vetveten që fëmijëve, patën a s'patëm buxhet edhe pse mendoj që ky nuk është arsyetim a do të kemi mjete financiare për shtesa për fëmijë, për se shkak se ndarjen e mjeteve e bëjnë në bazë të prioriteteve dhe nevojave. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Urdhëro Nënkryetar.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Në rregull Kryesuese, le të jetë si propozim dhe le të shkon në administratë. Përfshijmë të çështja vlerave që nuk mun mu përcaktu në rregullore sepse mundet me pas kryetari që ka vullnet 5 mijë euro me financu një nënë lehonë. Prandaj ajo përcaktohet me vendim, kështu që për pjesën tjetër jam krejt dakord përjashtoj vlerat financiare.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po atëherë, Selman të lutem e përcjellë me shkrim. Egzona fjalën.

Bujar Hasani (I pavarur): Në qoftë asambleja voton për rregulloren.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Të lutem Bujar, me radhë ta marrim fjalën.

Bujar Hasani (I pavarur): Kush ke me radhë?

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): I ke edhe 3 përpara, Egzona, Islami, Dafina pastaj ju zotri Bujar.

Egzona Hoxhaj (PDK): Faleminderit Kryesuese. Atëherë unë e kam një propozim të drejtorja për kulturë rini e sport, konkretisht te fusha e kulturës. Po tregohen aktivitetet edhe organizatat që kanë mbështet. Unë e kam një kërkesë prej organizatave të komunitetit të aftësisë kufizuar që veprojnë në komunën e Prizrenit, mu përfshi edhe ato për shkak që ato janë organizata që më status janë për shërbime sociale po duhet me pas parasysh që na në janarin e vitit 2024, kemi me votu në kuvend dhe strategjinë komunale dhe plan të veprimit për personat me aftësi të kufizume ku një prej fushave që kanë mu përfshi është gjithë përfshirja e personave me aftësi të kufizume në jetën kulturore sportive edhe rinore në qytetin e Prizrenit edhe nëqoftëse, mendoj që nëqoftëse nuk cekën organizatat e personave me aftësi të kufizume te fusha e kulturës kanë mu penalizu te pjesa e mbështetjes financiare për këto. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Egzona fjalën e ka Islam Thaqi.

Islam Thaqi (LVV): Faleminderit Kryesuese. Parimisht, unë e përkrahi Selmanin me propozimet edhe pjesën që Egzona e ngriti. Mirëpo, kërkoj që te neni 1 të plotësohet pika e dytë për shkak se në thelb subvencionet paraqesin politikat e një kryetari në pushtet të cilat do mi përkrah. Po thelbi i subvencioneve gjithqysh duhet të jetë Nënkryetar që subvencionim të përkrahën qytetarët në ato fusha ku nuk mund t'i ofrojmë shërbime. Do të thotë, si në shëndetësi kur jepet subvencionim apo përkrahën financiarisht personat të cilat trajtohen me kancer, do të thotë ne si shërbim trajtimin në nivelin që është shëndetësia nuk mund ta.. nuk mund ta ofrojmë duhet ta ofrojmë por pjesërisht. Prandaj te neni 1 mendoj se duhet të shtohet “komuna ndanë subvencione financiare në pamundësi për të ofruar shërbimet të cilat nuk i ofron komuna duke bërë transfere grante edhe i specifikon fushat: arsim, kulturë, rini, turizëm, zhvillim ekonomik e të tjera. Do të jemi të qartë pse jepen subvencionet, është e drejt ligjore e kryetarit se cilat fusha do mi përkrah më shumë e cilat më pak. Atë ligji ja mundëson, këtë e kemi të kuartë të gjithë. Mirëpo, thelbi subvencionimit duhet me qenë aty ku nuk mund t'i ofron shërbim të përhershëm dhe të menjëhershëm. Mendoj se kjo duhet veç të bëhet riformulimi i i kësaj pike do të thotë të dytë në fjali. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit. Urdhëro Nënkryetar.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Në rregull është domethënë një propozim me vend kurse sa i përket llojit të sëmundjeve ato janë të përcaktuara te neni 27, po janë të përcaktuara edhe çka mundet me financu komuna edhe çka qeveria, për mua në rregull është.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit. Dafina fjalën.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit. Nënkryetar, ne në vitin e kalum si gra kuvendare ju besuam fjalëve të juaja, edhe ju lamë në dorën tuaj subvencionimin. Falë neglizhencës, gratë që kanë bërë lindje më 2022 nuk fituan. A është qashtu kolege të dashura? A bënë na me siguru veten me këto çmime të cilët janë propozuar edhe është dy mandate është votuar ky vendim. Gratë, lënani bre neve ta vendosim çfarë çmime ka, ju nëse e keni vullnetin, nëse e keni vullnetin, këtu na keni me kismet vini na propozoni edhe thoni: ‘përveç që po duam me respektu rregulloren kryetar i ka vullnet me bo 500, 600 ishalla sa më shumë e rritë’. Po jo, ju po e kufizoni se na nuk kemi më besim tek ju me ju dëgju juve. 2022 gratë u diskriminun! Ka plot gra të cilët nuk kanë pranë me marrë, domethënë nuk kanë arritur me marrë qetë subvencion të cilën e kanë pasur të drejt, të cilën përfaqësueset e tyre e kanë votuar. Andaj, mendoj që shuma domethënë është tepër me rëndësi të caktohet, nëse e rritni jeni të mirëseardhur. Këtu jemi, ndërrohen vendimet, ndërrohen rregulloret, vullneti është, kjo është e para. E dyta, rekomandimet e mia përveç kësaj është pjesa e transparencës, mendoj që përveç emrit të organizatës përfitues apo individëve përfitues si te lista preliminare ashtu edhe përfundimtare duhet ti përmbajnë këto: mënyrën e përzgjedhjes së tyre, pra metodologjia dhe pikëzimi, shuma e përkrahur nga komuna për secilën përfitues dhe organizata si dhe anëtarët e komisionit, pra emrat dhe mbiemrat. Po ashtu, raportet për të gjithë përfituesit dhe organizatat të kenë rregullore të specifikave si kohë dedline që kanë t’i shpalosin, për shkak që ne kemi listë të subvencioneve por gjithmonë është e domosdoshme mu bë kërkesë për secilin raport. Shuma e dhënies së subvencioneve të plasohet në ueb-faqe, sepse nuk plasohet shuma, plasohet vetëm lista. Këto i propozoj që ta dmth ta kemi parasysh edhe raportet e secilit përfitues ti kemi në faqen të komunës. Edhe, a është mundësia me bë monitorimin e këtyre projekteve a po realizohen apo jo, sidomos te pjesa e individëve kemi një çalim tek monitorimi. A është mundësia me shtu

monitorimin këtu, kur të shpaloset lista me shpalos edhe personin përgjegjës i cili është kompetentë për monitorimin e projekteve të realizuara?

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Dafina. Po urdhëro Nënkyetar.

Kujtim Gashi (Nënkyetar i Komunës): Po pajtohem domethënë me gjithë ata që e tha Dafina. Te raportimi nuk diskutohet edhe rregullorja juaj që e keni përpara edhe e Qeverisë aty i parasheh, domethënë transparencën thotë minimale të paktën më pas. Që nënkupton raportimi monitorimi gjithë këto edhe e ki edhe këtu. Edhe gjithë ato çështje te metodologjia që kanë qenë edhe propozime kur është zhvilluar debati, janë dakort edhe është mirë me i përfshi.

Dafina Alishani (LVV): a do të përfshihen?

Kujtim Gashi (Nënkyetar i Komunës): Patjetër, nëse është propozimi i juaji, tash vendoset në votim edhe nëse kalon përfshihen. Tash unë s'mund e ndërroj rregulloren, e keni në dorë ju.

Ajo që unë s'pajtona është çështja e përcaktimit të kuotës për shkak se kjo nuk është rregullore për taksa, kjo është rregullore që e përcakton procedurën, do të thotë ti definojmë. Ne e kemi rregulloret tjera që përcaktojnë vlerat, kjo është rregullore që përcakton procedurën, a ke parë këtu diku vlera? Nuk ka! Në rastet të veçanta veç kur flitet për disa sëmundje ku janë përcaktuar në raportet edhe me ministrinë se cilat janë mundësitë e komunës dhe cilat janë të ministrisë. Përndryshe s'ka vlera këtu, kjo është procedurë edhe nëse kufizohet mundeni me vendos 250, 300, 350 qysh ishte propozimi dhe qysh është edhe sot në thirrjen publike dhe qysh besoj ka qenë edhe në të kalumen. Ju mundeni, por veç e kufizoni kryetarin nesër pasnesër me dashtë me i rritë! domethënë është e panevojshme kjo. Edhe tjetra sa i përket mbështetjes për vitin 2022, për këtë e kemi thënë kur e kemi diskutuar këtu, është çështje e mungesës së planifikimit të buxhetit nga ish qeveria për vitin, s'kam premtuar, për 23 kam thënë, ta bi procesverbalin kështu që s'bën me manipulu me debat.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, Bujar Hasani fjalën e ka.

Bujar Hasani (I pavarur): Faleminderit për fjalën. Unë përafërsisht e morra si me thënë përgjigjen paraprake për arsye sepse rregullorja për subvencione qenka e parapamë pa u përcaktu vlerat. Mirëpo, ne mund të ja shtojmë edhe një fjali nëqoftëse tash në fillim janë këto vlera të cilat po propozohen, e lëmë të hapur që mundësisht në qoftë se ka buxhet mundet mi rritë, vullneti i kryetarit mundet mi rritë ato vlera. Nuk do të thotë mos me i rritë, nëqoftëse qenka kjo sa për procedura, unë nuk di çfarë procedure duhet të parashihet në rregullore, një nënë lehonë kur dihet që ka lindur fëmijë edhe e qon çertifikatën e lindjes dhe mjafton kjo, e mjaftueshme është kjo. Ndërsa sa i përket vlerave, mirë do të ishte që baza fillestare që po propozohet 250 apo 300 sa janë, nëse ka vullnet në rritje edhe ka buxhet as kërkush kuvendarët s'besoj ka me qenë kundër që kryetari merr vendim. Por mos t'ia lëmë në disponim se ndoshta bën vaki me bë me më qëllu, do të thotë s'ka pare edhe nuk jep buxhet. Prandaj, ta bëjmë që buxheti le të jetë fillestar pastaj mbas të kapacitetit dhe në bazë të parave që disponon komuna, mund të rritet vlera. Kështu që, unë nuk pushon ndaj diçka të keqe në këtë propozim, i ftoj të gjithë të tjerët që ta përkrahin këtë propozim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, Iliri fjalën e ka.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit znj. Kryesuese. Edhe unë i kam 3 propozime. E para ka të bëjë me nenin nenin 6 pika 2, ku kufizohet aplikimi vetëm një herë në vit. Edhe këtu pra mos të ketë kufizime, nëse konkurruesi apo aplikanti ka përfunduar obligimet nga thirrja e parë, atëherë të ketë të drejtë edhe për thirrjen e dytë. Neni 6 pika 2. Mos të jetë me përjashtime, do të thotë të jetë një rregull që nuk ka kufizime, do të thotë i ke kryer obligimet, e ke përfunduar projektin, atëherë mundesh me apliku edhe për për tjetrin sepse kështu le hapësirë me kriju standardeve të dyfishta, që për dikë lejohet për dikë tjetër mos mu leju. Besoj se kështu kishte masmiri që të mos ketë kufizime, nëse ka kryer obligimet kuptohemi ndaj subvencionit të parë paraprak. Propozimi i dytë ka të bëjë me nenin 7 pika e 1, a ekziston mundësia që subvencionet të jenë të hapura gjatë tërë vitit. D.m.th. proceduralisht a kemi të drejtë? Nëse jo, atëherë me këqyr mundësinë që me bo 3 ose 4 herë në vit thirrje për subvencionim nëse ka pengesa që ajo të jetë e hapur përgjatë tërë vitit. Unë e kam të qartë që neni 14 i jep mundësi kryetarit në rastet specifike të subvencionojë aktivitete të ndryshme. Por kjo që mos mbetet në mëshirë të kryetarit, komisioni zaten është për tërë vitin. Kështu që, të jetë hapur ose të ketë më shumë më shumë thirrje për, kryesisht e kam fjalën për OJQ-të, për organizimin e aktiviteteve të ndryshme, fushave të ndryshme. Dhe propozimi i tretë ka të bëjë me shëndetësi, është neni 27. Unë u interesova me persona të prekur me diabet dhe u informova që insulinat i pranojnë nga ambulanca nga QKMF-ja, po në rregullore nuk vreja për insulina! do të thotë vijnë nga ministria apo janë nga komuna ato? Nëse insulinat vazhdojnë të sigurohen nga komuna, atëherë propozoj që të sigurohen sensorët për matjen e diabetit që vendosen në kraharor, është kërkesë e personave të prekur me diabet. Kjo ndikon në cilësinë e jetës tyre edhe në përcjelljen e nivelit të sheqerit dhe parandalimin e pasojave që mund të ndodhin nga rënia apo ngritja e nivelit të sheqerit. Pra edhe njëherë, nëse insulina nuk është përfshirë atëherë a mund të përfshihet? Nëse është e përfshimë, unë nuk e pashë në rregullore, atëherë së paku ta përfshijmë edhe sigurimin e aparateve-sensorëve për matjen e nivelit të sheqerit që ngjitet në kraharor, faleminderit për dëgjimin.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Ilir. Po Nënkryetar.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Ta kemi parasysh, në komision 90% kanë qenë juristë, në komision për hartim të rregullores, të gjithë më ekspertë se ne këtu, edhe punëtorët që kanë punuar gjatë nëpër drejtoritë përkatëse. Domethënë propozimet e tyre duhet mi marrë me seriozitetin ma të madh sepse ata ballafaqohen në baza ditore me këto farë çështje. Sa i përket çështjes se a duhet me marrë dy herë dhe me leju dy herë, kjo është propozim prej vetë drejtorisë edhe juristave që kanë punuar me këto nene. Për faktin se ka pasur raste ku për të njëjtën thirrje kanë aplikuar dy herë, ka përfituar e parë, ka përfituar edhe herën e dytë shpesh edhe pa i mbyllur projektet. Tash këtu është bënë një mes, një zgjidhje te neni 3 ku thuhet: përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, bëjnë subvencionet transfertë dhe grante të ndara për specifike dhe të arsyetuara nga komisioni. Nëse komisioni e arsyeton në thirrjen e dytë që ai mund të përfiton edhe në thirrjen e dytë siç kanë fituar në thirrjen e parë është ok. Por, është nën autoritetin e komisionit, domethënë do sene duhet mi lanë na tek ata që janë profesionistë të fushës e jo ne ti imponojmë si vendimmarrës këtu politikë. Sa i përket insulinave ato vijnë nga ministria, domethënë nuk i financon komuna, për ato matsat ato janë diçka tjetër, s'besoj që mundet mu parapa në rregullore, është çështje e vendimeve që duhet mi marrë ekzekutivi. Por, edhe njëherë përfundimisht po them ta kemi parasysh, kjo është rregullore që e përcakton procedurën, mënyrën, format se si subvencionohet. A ka mjete, kryetari mundet me shpall dy herë, tri herë, katër herë, s'ka përfundon me një thirrje. Vitin e kaluar faktikisht këtë vit janë kanë 2 thirrje publike dhe në bazë të afateve

ligjore që parashihen në këtë rregullore dhe me dashtë nuk mundesh më shumë. Sepse një muaj është thirrja, një muaj është koha e përcaktimit se kush ka fituar, pastaj koha e ankesave, derisa të fillon edhe nënshkruhen kontratat, janë diku nja 4 deri 5 muaj kohë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Nënkyetar. Kujtesa e ka fjalën.

Kujtesa Kabashi Shatri (LDK): Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Ne e dimë që mandatin e kaluar grupi grave kuvendare e ka rregullu do të thotë kuvendi, kryetari i kaluam që 2021 i kanë marrë nënat lehona këto shtesa, pasi që vetë jam marrë me këtë punë edhe në emër të grupit grave çdo herë kam fole për këtë çështje. Në 2021 kur kemi filluar do të thotë mandatin, unë e kom kërkua prapë këtë kërkesë që të realizohet pasi që është mirëprit nga nënat lehona. Zoti Kujtim, ka thënë që do të merret me këtë çështje edhe ne kemi kërkuar që jo më vendim, mirëpo të rregullohet me rregullore. Tashti nuk e di a është neglizhenca atij apo nuk ka pasur mjete, këta e dinë. Mua më vjen shumë keq për nënat e 2022-tës, që nuk i kanë marrë këto, se më kanë shkruar shumë, do të thotë që nuk i kanë marrë këto. Kështu që, faleminderit edhe prej Selmanit, për ne është kanë edhe kjo kërkesë prej neve që të rregullohet me rregullore, që kjo çështje mos të merremi ne çdo vit. Mirëpo të merremi me çështje tjera, se pasi që jemi edhe grupi grave kuvendare na çdo herë do ti përkrahim nënat, gratë. Na e kemi edhe nga Drejtoria e Shëndetësisë janë shtuar 100 euro për personat janë më kancer të gjirit. Unë e kisha kërkuar që prapë të shtohen edhe 100 euro, po flas në emër të grupit grave pasi që kemi mjete, mundemi. Kështu që kaq është kan, kështu është kanë unë e sa e di, nuk di më tepër. Faleminderit

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Kujtesë. Atëherë po Nënkyetar.

Kujtim Gashi (Nënkyetar i Komunës): Veç shkurt se shpesh për keqinterpretohet çështja e vitit 2022. E para ish qeveria e ka lan komunën pa buxhet të miratum, buxheti është miratuar mbasi e kemi marrë na mandatin në mars, me 15 mars nëse nuk gabo. Ka shkuar në qeveri është kthyer prapë, është kërkuar edhe një herë me u votu, prap e kemi votuar prill, ka shkuar në qeveri dikun kah maji është lejuar buxheti mu implementu. Kjo është korrekte, aty nuk ka pasur planifikim për nënat lehona, d.m.th. nuk ka pasur. Ne e kemi miratuar buxhetin që e kemi gjetë si draft, nuk ka pasur planifikim për nënat lehona. Dhe në 2023, e kemi shpall thirrjen për pagesat e vitit 2023, në fakt 2022, ndërsa 2023 e kemi me buxhetin e planifikim edhe nuk e kemi ma me thirrje por e kemi të përfshime në qet rregullore, e kemi bërë zgjidhen njëherë e përgjithmonë. Se ka ba Sokoli, na.

Kujtesa Kabashi Shatri (LDK): Nuk e pata, unë thash për tash që po propozon, e falënderoj që po na përkrah neve si gra se edhe na tash edhe na tash dojmë që më vazhdu kjo që mos të merremi ma me këtë temë sepse edhe u bë shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit. Atëherë propozimet që u dhanë këtu të gjitha ato.

Selman Sokoli (LVV): E para rregullorja përcakton shifra nuk është e vërtetë që s'përcakton, rregullorja është edhe për shifra përveç se rregullon. D.m.th. është në diskrecionin e Kryesueses si propozuese e rregullores ligjërish, mi përfshin disa gjëra qysh ajo e she rregullimin e jetës në Komunën e Prizrenit në këtë fushë. Përveç procedurave dhe kritereve që ka shumë mangësi që duhet të përmirësohen, ka edhe shifra, ka shifra është 5000 euro si rast. Edhe për mos me na ardhë

naj kryetar ose naj pushtet i papërgjegjshëm sipas Gashit, ne e kemi propozu në të ardhmen pra një amendament. Amendamenti ynë është shumë i qartë, po besoj gratë janë duke kërkuar që dy vite, e mos me vazhdu prapë me kërku por e kanë si të drejtë ligjore që nëse komuna nuk ja jep, këto munden me i marrë përmes përmbaruesit, këtë duheni me pas të qartë, është një drejtë ligjore. Por nëse në të ardhmen ka mu arsye kryetari që s'kanë mjete ndoshta në 2030-tën, mos të bëjmë tash politikë ditore. Kryesuese, edhe shifrën nuk e kemi përcaktuar me idenë hajde tash na të bëjmë shifra. Në bazë të vendimit të fundit të kryetarit i kemi përcaktuar shifrat, nuk kemi thënë 400, 500 e 600 euro që me u duk jo serioze kjo. Por amendamenti është pikërisht me mundësitë. Vazhdimisht është duke u arritë që tre vite. Kështu që, po besoj si amendament, nëse hidhet në votim hidhet si i tëri, veç nëse dojnë asambleistët me ndryshu diçka.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Shumë shkurt, e para propozimet një për një, shkojnë në votim se janë propozime. Po pra qashtu la Shuk edhe unë tre si ti, por në rregull tash jemi. Veç po du për asambleistin që e di që është jurist, ky duhet me ditë që ti mundesh me qitë sa të dush shifra përditë. Pa vendim të kryetarit, neni qetij s'implementohet, prapë duhet një vendim i kryetarit, si jurist duhet me ditë zinxhirin e mënyrës sepse kryetari i menaxhon me financa, këtë e ka përcaktuar ligji për financat, kryetari menaxhon me financat, kuvendi i miraton. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Nënkryetar faleminderit. Atëherë po e qesim në votim edhe amendamentin domethënë me gjithë vlerat. Por meqenëse Nënkryetari po thotë nuk mund të përfshihen e qesim edhe si propozim të dytë, domethënë pa përfshirjen e vlerave. Mirëpo me ato propozimet që mund të përfshihen në rregullore.

Selman Sokoli (LVV): Jo me ndryshu amendamentin, ose e voton, ose s'e voton. Pa vlera nuk ka efekt ky. Unë thashë mos me na ardhë naj kryetar në thonjëza i papërgjegjshëm prapë kjo është, nuk n'varet vendimi te diskrecioni i kryetarit. Nëse rregullohet, jo jo, unë fola për të kalumen nuk e pata fjalën për ju, se ju po pretendoni se kryetari i papërgjegjshëm nuk ka lanë mjete apo? E nëse e bëjmë na me rregullore, s'ka planifikim mirë e çka të dush thuj. Mos me mujt me ardh një kryetar që s'planifikon mirë, e kemi rregulloren. Përmes rregullores që e harton asambleja, e jo kryetari, nuk varet asgjë këtu prej kryetarit, nënat lehona munden mbi arkëtu mjetet në forma edhe ligjore, përveç formave tjera. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po Dafina urdhëro.

Dafina Alishani (LVV): Kryesuese, a bënë amendamentin si grup që e kemi propozuar me votu kaq. Kjo është e drejta jonë po besoj.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po atëherë do ta qesim në votim edhe me amendament edhe pa këtë. Prezent jemi 27, anëtar 28 anëtar. Po e qesim amendamentin e plotë si e ka sjellë Lëvizja Vetëvendosje, jemi në procedurë të votimit. Prezent jemi 28 kush është për? Të lutem i ndëgjuam, është çështja krejt te vlera.

Ertan Simitçi (YHTP): Kryesuese, duheni me lexu mirë amendamentin, që me ditë çka po votojmë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Qe unë po e lexoj. Atëherë kështu, amendamenti propozuar nga grupi asambleistëve Lëvizja Vetëvendosje: subvencionet për fëmijët e posalindur si pikë e parë 1.1 për të aplikuar për subvencione për fëmijë të posalindur prindërit aplikues duhet të plotësojnë këto kritere: 1.1.1, po shkoj me radhë kështu: të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, të dy prindërit të jenë banorë të Komunës së Prizrenit, dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për fëmijë të posalindur janë: dokument identifikimi, ekstrakti i lindjes së fëmijës, deklaratën e bashkisë familjare, konfirmimi i llogarisë bankare i njërit prind, subvencioni për fëmijë të posalindur ndahet: për fëmijën e parë 250 euro, fëmijën e dytë 300 euro, fëmijën e tretë domethënë 3, 4 që vijnë me radhë nga 350 euro. Paga bëhet për çdo fëmijë individualisht dhe aplikimi zgjat 3 muaj nga dita e lindjes së fëmijës. Ky është. Po Nënkyetar.

Kujtim Gashi (Nënkyetar i Komunës): Veç shumë shkurtë, veç me thënë që ju me këta jeni tu e kufizu rritjen e vazhdueshme që mun mu planifiku viteve të ardhshme, ta keni parasyshë. Vlerat e përcaktojnë strikt, nëse kryetari shpreh vullnet vitin e ardhshëm me ba 500, me këtë nuk mundeni me bë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Atëherë po e qes në votim amendamentin.

Haziz Hodaj (LDJ): Veç një moment, se nuk pata me diskutu por më shtyni Nënkyetari. Atëherë do të ishte mirë që me e përcaktu shumën minimale dhe për rritje nuk ka problem le të jetë e hapur. Por shuma minimale le të jetë njëra prej këtyre që i propozuat.

Kujtim Gashi (Nënkyetar i Komunës): Haziz, shuma minimale ndër ato që është shpall nuk bjen, s'ka logjikë!

Haziz Hodaj (LDJ): Le të evidentohet që kjo është shumë minimale me të cilën mund të sponsorizohen.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Pra, i shtohet edhe shuma minimale. Prezent jemi po e hedhim në votim me amendamentin komplet po e qesim. Prezent jemi 29 anëtar, kush është për? veç 14 janë për, kush është kundër? 13 kundër, abstenim a kemi? 1 abstenim. Kjo ishte me amendament, domethënë pa amendament siç ka qenë rregullorja po e hedhim edhe një herë në votim.

Selman Sokoli (LVV): Kryesuese, amendamenti kaloi në rregullore me propozimin shtesë të LDK-së, që këto shuma të jenë minimale. Nga vendimi i kryetarit le t'i bën 500, 600€ le të tregojnë gjenerazitetin. Ky ishte propozimi, kjo rregullore kaloi, kjo punë u përfundua Kryesuese, mos të ketë probleme. Kjo nuk votohet më, kaloi amendamenti i propozuar nga radhët tona. Rregullorja në tërësi tani del në votim.

Kujtim Gashi (Nënkyetar i Komunës): A ka kaluar, a s'ka kaluar e përcakton ajo që menaxhon seancën, a i ka numrat edhe i numëron, e para në votim ke amendamenti. E dyta kjo që propozoj Hazizi tash kjo s'ka ma logjike sepse minimalet që janë përcaktuar ti i ke shti në përkufizimet që i ka bë Vetëvendosja.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Jo jo, unë e qita me amendament komplet edhe e votuam, diçka tjetër nuk përmenda.

Selman Sokoli (LVV): Qashtu minimum, minimum, a e kthejmë seancën. Minimalja e Nismës edhe që e ka përmend zotëri Hodaj edhe kaloi, nuk jemi nevojë me ba kësi.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Tash a janë të përcaktume shifrat apo s'janë?

Selman Sokoli (LVV): Minimale zotëri Nënkryetar, nëse doni mi rritë, shifra minimale është 250 euro, për fëmijën e parë, minimalja është 300 euro për fëmijë e parë, minimalja 350 euro për fëmijën e parë.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Veç minimalja?

Selman Sokoli (LVV): Po.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Dakort!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po, faleminderit. Atëherë po shkojmë me 1 orë pauzë. Tash rregulloren po e qesim në votim bashkë me amendamentin me këto vlerat minimale.

Dafina Alishani (LVV): Përveç vlerave dhe çështjes së nënave lehona, kërkesat tjera a po mirren parasysh si ndryshim?

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Nënkryetari tha që po, të gjitha ato që po përfshihen. Pra po e qesim komplet edhe një herë në votim. Prezent jemi 32 anëtarë. Kush është për bashkë me amendament me propozime tjera të cilat kanë mundësi përfshi. 32 jemi prezent. kush është për? ju lutem a jeni të gjithë sepse disa nuk e kanë ngritur dorën! 28 janë për. kundër a kemi? Ju lutem, ju kisha lutur mos diskutoni gjatë procesit. Tash dora po ngritet tuj bisedu. Edhe njëherë po e hedhim votim, të nderuar anëtarë, të nderuar anëtarë. Prezent jemi 32 anëtarë, kush është për edhe një herë ju lutem? 30 jemi për, kush është kundër? 0 kundër, abstenim? zero abstenim. Atëherë kalon kjo pikë e rëndit të ditës. Ju faleminderit shkojmë 1 orë pauzë dhe ju lutem të ktheheni me kohë edhe ta përfundojmë sa më herët.

PJESA E DYTË

Pika e Gjashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për miratim paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2024;

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit që u kthyet në sallën e kuvendit për të vazhduar pjesën tjetër të mbledhjes, siç e dini, kemi mbetur te pika e radhës, që ishte pika e njëmbëdhjetë dhe që kaloi tani më në radhë shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për miratim paraprak të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2024.

Karanfil Haxhillari (LVV): Neve që ishim këtu në kuvend, e lamë që me e kalu pikën e rendit të ditës dhe kryetari me u kthye dhe me vazhdu pikën për raportin e punës së kryetarit të komunës për gjashtë mujorin e dytë. Kryetari nuk u kthye edhe kjo është me të vërtetë një papërgjegjësi e kryetarit ndaj këtij kuvendi, edhe përveç kësaj edhe pyetje përgjigje nga drejtorët nuk patëm, pra ishte një injorim total ndaj kuvendit, për këtë arsye edhe na si kuvendarë e lëshojmë sallën dhe nuk kemi t'i përgjigjem nuk kemi nevojë t'i përgjigjemi këtij injorimi.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Karanfil derisa zbret kryetari, besoj që do të na bashkëngjitet sepse unë u interesova kur erdha teposhtë sepse ishte në një takim. Kështu që po vazhdojmë me këtë pikë besoj që ai në ndërkohë do të na bashkëngjitet. Atëherë po vazhdojmë po zotëri Gursel fjalën e ka.

Gursel Skenderi (Sektori i Pronave): Përshëndetje për të gjithë! Sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale dhe rregullores, të gjitha komunat duhet të aprovojnë listën e përgjithshme dhe listën e veçanta të pronave komunale për vitin vijues. Andaj edhe ne si komunë kemi obligim ligjor që këtë listë të aprovojmë. Duhet të theksojm se kjo listë ndryshon nga vitet paraprake sepse është bërë rifreskimi i listës nga drejtoria për gjeodezi dhe kadastër gjegjësisht nga drejtori Sengjar Karamuço. Andaj ju njoftojmë sipas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL, kjo listë shpallet në veb faqen e komunës. Për shkak të rëndësisë që ka kjo listë kërkoj që lista pronave komunale të aprovohet nga ana juve faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit zotri Gursel. Po Petriti fjalën!

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. Unë e kam edhe një pyetje masi është edhe sektori pronave dhe kam pas në pyetje përgjigje për me kërkuar prej këtyre. Lidhur me pronën në rrugën në Remzi Ademi prona me numër parcelës të fundit po e ceki 02338-1, ku sot operon Vektori. Çka është duke ndodhur me këto? A ka lidhë kontratë kompania që është duke shfrytëzuar këtë parcelë ose këtë objekt dhe nëse jo pse nuk është në listën e vitit 2022 ? Faleminderit!

Gursel Skenderi (Sektori i Pronave): Për këtë për këtë pronë domethënë është zhvillu tenderi, mirëpo tenderin e parë në tenderin e parë nuk ka pasur edhe ka dështu. Shumë shpejt komisioni në fjalë kam me ri tenderu atë pronë dhe disa prona të lokale në bazhdarhane të cilat nuk kanë pasur ofertues edhe do të lidhet kontrata.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Mirëpo tash kërkoj me shkrim të dërgohet se a është duke duke paguar qiratë dikush për këtë shfrytëzim, sepse me ligjin e ri, me ligjin dhënien në shfrytëzim momentin kur dështon atëherë ju qitet çelësi sikur shumë lokaleve tjera pse nuk është çelësi deri më tani? Kërkoj me shkrim të na dërgohet pse nuk është qitë dhe a ka pagesë të qirasë deri tash faleminderit?!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Petrit dikush tjetër në lidhje me këtë pikë nëse të dëshiron me marrë fjalën? Po zotri Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit kryesuese. Jo deshta veç po kërkojë ndjesë, për shkak për shkaqe teknike nuk e kam këtë materialin e këtyre pronave, që duhet sot me i shpallu edhe me marrë vendim për to. Po e kam fjalën për një parcelë në shkollën poshtë në Gjonaj, na e kemi bë në fakt një marrëveshje që në vitin 2002 me pronarin, dhe e kemi bërë një këmbim pronash mirëpo ajo ende nuk është legalizuar. Po të lus Gursel, nëse nuk e ke problem shiko me drejtorinë e kadastrit, merre atë numër edhe fute edhe atë pronë në listë sepse ajo patjetër duhet të rregullohet brenda vitit. Duhet të legalizohet sepse marrëveshja është çdo gjë është e kryme, përveçse legalizimit edhe me bo zyrtare qatë këmbim që është bërë. Nuk e di numrin e parcelës!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, dikush tjetër? Në qoftëse nuk ka, atëherë po e hedhim në votim pikën radhës prezent jemi 23 anëtarë! Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës, bashkë me propozimin? 21 jemi për. Kush është kundër? 0 kundër. Abstenim? 1 abstenim. Atëherë miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e Shtatë

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Përzgjedhës (DKA) sipas kërkesës së MAPL-së;

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po Nënkyetar.

Kujtim Gashi (Nënkyetar i Komunës): Kjo pik ka qenë edhe në seancën e kalume edhe për shkak të kuorumit është rikthyer për rivotim. Drejtoresha është me një rast vdekje, me një varrim, kështu që po e marrë obligim në emër të saj me e ri propozu votimin për këtë pikë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Nënkyetar. A ka dikush diçka rreth kësaj pike? Atëherë po e hedhim në votim prezent jemi 22 anëtar. Kush është për që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës? 17 për. Kush është kundër? 4 kundër. Abstenim? 2 Abstenim. Domethënë me 17 vota për, 4 kundër, 2 abstenim, miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e Tetë

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm (hapja dhe ndërtimi i rrugës – Lagjja Bajram Curr);

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po drejtor fjala për ju.

Çelë Lamaj (Drejtor DSHP): Faleminderit kryesuese, të dashur kuvendarë. Është një projekt i cili e lidh lagjen Bajram Curri me lagjen e Trimave, janë shpronësu gjatë këtij viti diku 10 prona private, na ka mbetur edhe prona e cila është nën AKP, fjala është te farmakosi i ri edhe kërkojmë nga ky kuvend që ta miratojmë këtë propozim që ta fillojë me shpronësimin e asaj prone dhe gjatë vitit 2024 të realizojmë një projekt i cili është me qenë një arterie që siguron komunikim dhe shkarkimin e komunikacionit, një pjese të madhe të komunikacionit në komunën e Prizrenit. Faleminderit!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit drejtor. Dikush rreth kësaj pike nëse dëshiron me e marrë fjalën? Nëse jo atëherë çka është mirë është mirë po faleminderit! Atëherë po hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent 22 anëtarë. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Unanimisht. Faleminderit shumë kalojmë te pika tjetër.

Pika e Nëntë

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.001/011-38749 dt.10.03.2022 për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prizrenit;

Çelë Lamaj (Drejtor DSHP): Dua të ju sqaroj që tash një vit, domethënë muajin dhjetor ka qenë një takim i parë në kuadër të ministrisë së zhvillimit të ekonomik. Mes ministrisë, disa komunave të Kosovës edhe një agjencioni gjermanë, të cilët mendojnë të investojnë në deponitë në nivel Kosove. Kërkesa e vetme dhe kushtëzuese me thanë, ka qenë në atë kohë që komunat duhet t'i rrisin tarifat e inkasimit të mbeturinave, nëse donë implementojnë projekte të deponimeve me standardeve evropiane. Para së gjithash prej krejt deponive nivel të Kosovës që janë pesë apo gjashtë, deponia Landovicës ka pasur një prioritet ku mendohet që të investohet mbi 10 milionë. Unë e di që nuk është reprezentative sot qytetarëve tonë me ja u ngrit përnjëherë, ka qenë një komision i formuar katër drejtorisë e cila prej katër euro gjysmë e kemi bërë pesë euro e gjysmë. Është propozimi për 5.50 euro faktikisht komunat tjera edhe Rahoveci ka 6 euro, Prishtina e ka 6, Obiliqi, shumë komuna më të vogla se komuna e Prizrenit kanë tarifa më të larta. Komisioni ka propozuar për pesë pikë pesë euro domethënë për një euro me u rrit kjo tarifë, kështu që kisha me kërkuar që për shkak të investimi jashtëzakonshëm që pritet, ata deponinë e Landovicës na kanë pasur prezentuar një farë projekti edhe ideor, prej të vetmeve deponi në Kosovë, kjo Landovicës ka pas një lloj prioriteti edhe kërkojmë nga ju që ta miratoni. Mirëpo ky vendim na kena menduar që derisa të mirrën dhe fillimi i këtyre pagesave fillon prej muajit qershori, korrik. Dmth gjashtë muajt e parë derisa të njoftohet mirë opinioni, kështu që kërkojë që të miratohet edhe ky propozim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit drejtor, fjalën dikush nëse donë me marrë? po zotri Hodaj edhe Petriti pastaj.

Haziz Hodaj (LDK): Kryesuese, unë fakt nuk e pata me marr fjalën po meqë u përmend deponia e Landovicës, masi nuk e ngrita në kuadër të pyetjeve dhe përgjigjeve po e ngris tani se bëhet fjalë pikërisht për atë deponi. Unë jam këtu anëtar i kuvendit që nga viti 2000 dhe kur është bërë propozimi, kur është ardhë projekti dhe është prezantuar me sllajde nga kompania, na është thënë që ajo deponi ka me qenë, ka me u shndërru edhe në një pikë turistike, pikë pushimi, rekreacioni, për piknike tjera tjera, aq keni prezantim brilant sa na qiti para aktit të krym. Sot po ju them që gjendja në atë deponi është e tmerrshme, është e tmerrshme përveçse fshati Landovicë edhe fshatrat e tjera për rreth vazhdimisht e shijojnë atë aromën e kësaj deponie, në momentet në kohën kur bjen shi, nuk e di a ju ka ra se më bjen shpesh më shku në atë rrugë për shkak se e marrë nipin në shkollë në Lojollë, kur bjen shi nuk mundesh me kalu prej baltës që bartin kamionët prej deri të rrethi atje te pojata që ka qenë, edhe ky rrethi tjetër të Kagu edhe te Shelli. Nuk e di a jeni në dijeni për këto, do duhej me u vu në lëvizje edhe inspeksioni, edhe drejtoria për shërbime publike edhe edhe edhe gjithë mekanizmat për me ia u dhënë një vërejtje, se përnime është e tmerrshme situata. Ai menagjim është nën çdo nivel, dhe janë skeptik edhe sot kur na thuhet që ka mu investu edhe 10 milion euro, nuk e di çka ka mu bë aty por që është në këtë gjendje nuk më të mohohet. Sa i përket rritjes në pak përpara edhe më shëfat e grupeve, na e patëm një takim sigurisht që për çështje politike na nuk do të duhet të lejonim rritjen e kësaj tarife, po kur i sheh ata punëtorë që punojnë me ato paga dhe e bëjnë një punë një punë kolosale, një punë fantastike, një shërbim... dua me i falënderu këtu edhe drejtorinë edhe edhe kompaninë atje për shërbim mjaft korrekt, në nuk kam has ndonjë regjion, qytet, që ka vërejtje rreth rreth shërbimeve që kryen ajo kompani. Andaj nuk do ta kundërshtojmë rritjen pavarësisht se çfarë është ajo. Faleminderit!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit zotri Hodaj, po Petriti, pastaj Ertani.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. Kur u përmend diku 10 milion euro do të ketë investime. A është me bashkëfinancim me ministrinë, a po me ndonjë organizatë të jashtme, a po është vetëm investimi i komunës së Prizrenit.

Çelë Lamaj (Drejtor DSHP): Ky është investimi qeverisë gjermane, qeveria gjermane, mendon që këto pesë deponi rajonale të investonë dikun përmbi 52 milionë. Deponia e Landovicës, ekzistuesja do të trajtohet domethënë me projekte moderne që qysh e tha edhe Hazizi, edhe ne na kanë thënë se trajtimi e kupton faktikisht që ajo pjesë duhet gjelbërohet duhet të zgjohet edhe të ndërtohet deponia, që thashë na kanë prezantuar një projekt ideorë i cili përmbush standardet evropiane të deponive. Ky ka qenë kushti i vetëm që komunat ta ngrisin tarifën e inkasimit të mbeturinave, dhe në atë takim dy takimet që janë mbajtur kam marrë pjesë unë. Ka qenë takim ndërministror, nivel kryetarë të komunave, mua më ka delegu kryetari me marrë pjesë edhe është votuar për të gjitha komunave të cilat deponitë janë brenda territorit të kadastral tyne. Kështu që, kjo është domethënë nëse ka me ardhë ky projekt, ka me kanë një prej projekteve më të mëdhaja që ka me pas jo vetëm Prizreni, po Kosova.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): faleminderit drejtor, fjalën e ka Ertani, pastaj Shkëlzeni.

Ertan Simitçi (YTHP): Faleminderit drejtor, sipas kërkesës apo edhe propozimit të drejtorit po parashihet që nga 4.5 euro të jetë 5.5 euro. Por, sipas shënimeve zyrtare që kam marrë nga raportet financiare në vitin 2020 borxhi apo obligimet në kategorinë të menaxhimit të mbeturinave është 3.7 milion euro, në vitin 2021 4.1 milion euro, ndërsa në vitin 2022 4.6 milion euro. Domethënë veç ne nuk po mundemi si komunë me i inkasu këto borxhet, të gjithë qytetarët edhe ne e dimë që taksat për mbeturinat është obligative për të gjithë shtëpitë apo edhe bizneset. Pyetja është pse nuk po mundohemi më i inkasu këto obligimet? Nëse kishim pasur një sistem të qëndrueshëm sipas rregullores, neni 5 po thotë: Komuna duhet të krijojë një sistem të qëndrueshëm financiarë për menaxhimin e mbretërinave dhe një krijimi të një sistemi të qëndrueshëm financiarë. Nëse kishim mundur ne me i inkasu këto mjetet më 4.6 milionë euro, kishim mund me i ble 10 kamion të reja të mbeturinave, kishim mundë të i punësojmë minimum 50 punëtor me 500 euro rrogë me të gjitha këto pajisjet që nevojitet. Kishim mund me i ble 1 mijë copë kontejnerë për mbeturina për komunën e Prizrenit. Domethënë neve veç i kemi rreth 5 milionë euro anash, po duhet të shqyrtojmë dhe të bisedojmë si të iniciojmë procedurat ligjore për ti inkasojmë. Po mendoj që nuk duhet të jetë vetëm rritja se edhe nëse rritet taksa për mbeturina apet do të ndikon te ata qytetarë që janë të tatim pagues të rregullte. Po edhe borxhi do të rritet tani, nëse rritet kjo, se ata që nuk kanë paguar deri në sot nuk paguajnë edhe nesër edhe nëse drejtoria e shërbimeve publike apo komuna e Prizrenit nëse nuk e krijon një sistem për inkasimin e këto mjeteve, besoni edhe nëse kanë informata ata zyrtar të qeveris gjermane kur kanë me pa që komuna e prizrenit s'ka mundur me i inkasu borxhet, besoni unë kam frikë që edhe ndoshta nuk mund të lidhet as marrëveshje. Për atë arsye unë kam dilemën këtu drejtorë që ta bëjmë zgjidhje për një sistem financiarë pak ma të qëndrueshëm, besoj që do të jetë më mirë.

Çelë Lamaj (Drejtor DSHP): Faleminderit Ertan. Komuna e Prizrenit momentalisht i ka të regjistruar diku 33 mijë amvisëri familjare, prej tyre 5 mijë s'paguajnë hiç. Të gjitha këto janë procedura të cilët me dy zyrtarë të cilët merren në sektorin e ambientit, është e pamundur me shku edhe me i pa se cilat janë ato biznese apo amvisëri familjare të cilët nuk paguajnë. Këtu është një konfuzitet dhe tjetër që është kjo është problemi menaxhimit, se ka njerëz të cilët e kanë shit shtëpinë kam ble një shtëpi tjetër, dikush e ka qitë në emër të vetin, dikush nuk e qit edhe i figurojnë atij tri shtëpia, ai paguan për një faktikisht ajo shtëpi duhet me qenë e tjetër kujna, apo është e pabanueshme. Kështu që, me i formu një taskë forcë ndoshta edhe vetë prej këtij kuvendi që më marrë me këtë pjesë kishte me qenë mirë, ne për grumbullimin e mbeturinave si komunë paguajmë afër një milionë e gjysmë euro si komunë. Kurse inkasimi është diku 1 milionë në 100 e diçka, kjo ka ndikuar në ramje për arsye që përpara ka pasur njëfarë kushtëzimi nëse do me regjistru kerrin ose për një dokumentacion tjetër është kërkuar edhe a janë pagu mbeturinat. Me ligjet e reja në fuqi të amandamentume domethënë është diskriminim është kundër drejtave të njeriut edhe e kanë hequr si obligative. Kështu që, është pak problem me mbërri deri te inkasomi qin për qin i këtyre. Po them me dy zyrtarë kemi lëndë të cilat shqyrtohen edhe 2020,2018,2017 tërë kohën punohet aty, mirëpo besoj që është njëfarë thesi i pafund, se me u marrë me 33 mijë amvisëri, po them ku ka shumë probleme në teren kur nuk janë të regjistruar si duhet, kujt dikujt nuk i figuron asnjë e dikujt tri e jeton vetëm në një shtëpi. Këto janë ato që tërë kohën nuk na përgjigjen i thërrasim telefonata, mundohen me pas kontakte të këtyre, me na pru dokumentacione për me mujt me zgjedh këto. Tërë kohen punohet, por ky është realiteti!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, Shkëlzen Kastrati fjalën, pastaj Bajram Kastrati.

Shkëlzen Kastrati (PDK): Përshëndetje për gjithë, në rend të parë duhet ta falenderojë kompaninë Eko-regjion që po bëni punë të mirë. Pasi jemi te kjo pikë, e pata një propozim vetura të cilat pengojnë rrugë është një kompani private e cila i bartë ato, e kryen këtë shërbim ndaj komunës Prizrenit. Unë kisha propozu që këtë shërbim me ia lënë Eko-regjionit le ta kryejnë edhe ashtu kështu çmimi është shumë i lartë për këtë shërbim, është 35 euro. Atëherë me një marrëveshje mes komunës dhe Eko-regjionit mundena me bo një çmim më të ulët 15 apo 20 euro, që dhe qytetarët përfitojnë nga kjo ulje për shkak të ndëshkime të tyre që pengojnë rrugën, po dhe buxheti Eko-regjionit rritet për këtë shumë për një shërbim të ri duke llogaritur që ni vetur në rrugën Adem Jashar apo Remzi Ademaj, do të thotë s'është as dy kilometra larg vend parkingit ku e dërgojnë ata, edhe nuk ka ndonjë kosoto të madhe edhe për Eko-regjionin për me krye këtë shërbim. Në këtë rast përfiton edhe Eko-regjioni me një shërbim të ri në rritje buxhetit, po edhe qytetari do të thotë e pagun gjobën e vetë do të thotë me një çmim më të lirë, ky ishte propozimi im, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Shkëlzen, Bajram Kastrati fjalën.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese. Drejtor the që ka me u bë investime te deponia këtu në Landovic. Kjo deponi për momentin shkakton, kundërmon, shumë shkakton telashe në ujë të pijes te qytetarët e Landovicës, në Arbanë shumë shpesh e bën jetën e padurueshme aq keq që kundërmon, sidomos kur punohet aty. Projekti që the e kemi parë projektin ideor, a i plotëson kushtet pozita e deponisë për atë projekt, a do të eliminohet ky kundërmim edhe telashe tjera që për ju shkaktojnë edhe qytetarëve të Landavicës dhe përreth fshatrave dhe Arbanës?

Çelë Lamaj (Drejtor DSHP): Unë ju thashë që është projekti i bashkimit evropian, është i qeverisë gjermane e cila punon projekte me standardeve dhe dhashë Zoti investohet se ajo ka me qenë që ska me pas kundërmim, por ka me qenë një pjesë a dinë kështu që nuk ka me pasur, ndoshta mbas atij projekti që na është prezantuar nuk jo që ka me pas ndotje të ambientit, ato parashihen deponitë thuhet janë deponime ekologjike. Kështu që, nuk ka më pas kësi probleme, po dhashtë Zoti pat investim. Tash gjatë vitit 2024 na kena pasur 2023-ën kemi pas 2 takime, mirëpo mbas sanksioneve të cilat ju kanë vu Kosovës nuk na... ka pasur mu mbajtje dhe në takim këtë vit, nuk është bërë, presim që është dhashtë Zoti të largohen edhe ato sanksione që u kanë vu Kosovës për investime të huaja dhe na implementohet. Besoni që ishte projekt që duhet me qenë të kënaqur krejtë nëse mundena me arrite një marrëveshje me ta.

Bajram Kastrati (AAK): Do të thotë është paraparë dhe pozita tash që larg ose afër objekteve këtë rast Landovicës dhe Arbanës. Është paraparë se ai përveç mund me shkakuar kundërmim ai po shkakton edhe telashe te uji i pijës te qytetarët e Landovicës.

Çelë Lamaj (Drejtor DSHP): Deponime ekzistuese bëhen investime, tash nuk e di sa është ai investim se ata pritet me siguri projekti kryesor, po për me mbyll ni herë deponin duhet me bë kogja një farë investimi. Pastaj për me hap një deponi tjetër e cila thuhet që është një lokacion diku 25 hektarë afër kësaj deponisë. Po hiç nuk është me rëndësi lokacioni se ku do të jetë ai lokacion, se kjo deponim ka mi pasur parametrat modernë të një deponie ekologjike faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Atëherë në qoftë se nuk ka dhe dikush tjetër po e hedhim në votim edhe këtë pikë prezenti jemi 23 anëtarë. Kush është për që të miratohet kjo pikë?

21 për. Kundër? 0 kundër. Abstenim? 1 abstenim. Miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës ju faleminderit gjithëve.

Pika e Dhjetë

Shqyrtimi dhe miratimi propozim-rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 001/011-99275 të datës 30 qershor 2023 për taksa komunale;

Bajram Kastrati (AAK): Kryesuese mundësisht veç edhe diçka. Edhe në këtë pikë edhe në pikën paraprake që ishim të pa çartë! Mundësisht para votimit të qartësohemi pak më në detaj tash këtë rast ne e votuam edhe çmimin e ngritjes apo? Është i parapamë me rregullore dhe nuk u përmend këtu çmimi absolut! Para votimit mundësisht edhe herëve tjera se edhe më herët ramë pozitë shumë të keqe edhe Kujtesa që po duhet me u sqaru pak më mirë se çka po votohet, të jemi veç ma të qartë, faleminderit.

Sulltan Badalli (Drejtor DEF): Faleminderit kryesuese. Pra kemi të bëjë me rregulloren mbi taksat komunale e cila është miratua me 30.06.2022 pra vitin e kalum, mirëpo më vonë me kërkesën e disa drejtorive është kërkuar plotësim ndryshim me bë nëpër pikë, nëpër nene të caktuara dhe më 23.12.2023 ne i kemi pru në kuvend përsëri me votu me ndryshime, po ka pasur kërkesa të ndryshme, ka pas mospajtime dhe e lamë që edhe njëherë të diskutojnë me kuvendarët për sqarime më të hollësishme më detajizume. Do të thotë me 15.12.2023 këtu në këtë sallë e kemi mbajtur edhe një takim me kuvendarë dhe jemi konsultuar dhe kemi diskutuar lidhur me me këto tarifatat të caktume. Prandaj, sot ju e keni rregulloren për taksa komunale, ë plotësim ndryshimi domethënë e keni të kompletuar dhe kërkoj që të votohet, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit drejtor, dikush nëse dëshiron me marrë fjalën rreth kësaj pike? Po Shkëlzen.

Shkëlzen Kastrati (PDK): Përsëritje edhe një herë. Vetëm desha me pyet te drejtorja për kulturë rini dhe sport, mos është bë ndonjë gabim drejtshkrimor te tarifa? Salla mundjes Selajdin Berisha dhe salla mundjes Multifunkionale, të thotë për një orë klubet sportive duhet me pagu 10 euro a po? Salla sportive paguhet 10 euro ora edhe kjo edhe kjo sallë 10 euro! Nuk kanë shans klube sportive me pagu këtë çmim, dy orë në ditë i mbajnë stërvitjet, 5 ditë në javë bëjnë 100 java! Tash a dojmë me i ndihmu klubet sportive apo me i ndëshku? Kush ju paguan qira tash klubeve sportive që shfrytëzojnë sallën? 400€ në muaj nëse një klub sportiv e përfaqëson komunën e Prizrenit i ka 20 garues apo 5 apo 50, dmth duhet t'i paguaj 400€ në muaj për me shfrytëzu sallën. Tash ne si komunë a dojmë me i ndihmu sportit a dojmë me i ndëshku ata tu i qit taksa? Se nuk është për rekreacion që e merr me shfrytëzu një ditë, është do të thotë trajnime ditore janë, javore, mujore, vjetore në këtë rast. Unë mendova që është bërë gabim drejtshkrimor e jo vendosja taksës.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Se di a ke marrë pjesë në këtë debatin e dytë që kemi mbajtur. E patëm para 10 dite po më duket, po me të 15 edhe aty i kemi trajtuar përfundimisht edhe tarifatat edhe krejt. Nuk ka sallë që mund me shfrytëzu pa pagesë pavarësisht kush e shfrytëzon. Nëse vendoset një standard vendoset për krejt njëjtë. 90% të klubeve në komunën e Prizrenit kanë

përfitu subvencione mbas thirrjes publike, ato që janë klube që funksionojnë normal. Një pjesë e madhe e tyre që mbajnë ushtrime, përgatitje duhet me fol kështu sinqerisht edhe me korrektësi marrin edhe pare prej nxënësve, sepse një pjesë e tyre janë si shkolla të sporteve. Kështu që, me një anë jep subvencione ndihmo klube, në anën tjetër liroji të gjithë pa pagesë, nuk e di në çfarë forme dhe qysh funksionon palestra, kush i menaxhon dhe kush i paguan shpenzimet e këtyre sallave. Është pak problem, tash a është çmimi 10 euro i lartë apo i ultë kjo është çështje që e kanë vendosur ekspertët, edhe kjo është përcaktu në dy takime që janë mbajtur në këtë sallë.

Shkëlzen Kastrati (PDK): Kujtim, me gjithë respektin çmimi është ekstrem i shtrenjtë! Ti nëse e ke një klub, ku ke me i marrë parat 400 euro në muaj me i pagu? Ato menzi veten po e mbajnë edhe subvencionet janë do të thotë në përgatitje që e përfaqësojnë komuna e Prizrenit në gara kombëtare edhe ndërkombëtare. Përgatitemi ne si komunë, unë mendoj kështu si si asamble si komunë duhet me siguruar ambient të favorshëm për u zhvilluar ata, e jo me ju qit taksa e me i ndëshku. Përndryshe do të shuhen shumë klube, edhe nuk ka logjikë një sallë nëse i ka 300 metra katrorë ose 500 me u barazu me qendrën sportive që i ka mija metra katrorë, për shfrytëzime të ndryshëm! Kenë nëse gabo i edhe sallat e shkollave mund me i shfrytëzuar ekipet e tjera, me një çmim të vogël dhe kjo duhet me u trajtu 0 ajde po them 1 euro në orë duhet me u caktu vetëm sa me thënë simbolike. Ashtu kështu ti po ia jep dikujt në shfrytëzim menaxhim dhe plus po ju qetë taksë, plus i kena kërkuar në një plan financiar çka ka me zhvillu atë vend, edhe pjesët e kësaj është edhe pagesa e rrymës gjësendeve tjera, faleminderit.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Kryesuese pa dashtë kështu me repliku edhe njëherë, besoj që vetëm tani javën e fundit e keni pa sa kanë ardhur faktuarat e rrymës, edhe paramendo sa paguajnë shpenzime sallat. Shpenzimi për reflektorë, shpenzimi për nxemje gjatë dimrit, për ftoje gjatë verës edhe sa i shkon kosto atyre vetëm rrymë pa fol për shpenzime tjera. Në anën tjetër Prizreni ka 70-80 klube ne si kemi 70-80 salla, janë këto që janë 3-4 edhe nja 3-4 nëpër shkolla qeto janë kapacitetet, vullneti do të kishte me qenë qysh po thu ti, me i dhënë krejtve me i shfrytëzuar pa pare, po është e pamundshme. Duhet me vendos një standard njëjtë për krejt, për këtë është bërë rregullorja edhe po besoj që kontributi për këtë rregullore tashmë është shtjerrë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit. zotri Hodaj, pastaj edhe Florenti.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit kryesuese. Ç 'është e vërteta ne kemi pasur edhe debatin publik, edhe kemi bërë disa propozime konkrete por nuk dijë a kemi arrit të gjitha pozicionet me i prekë!. Kam një një propozim konkretë te shfrytëzimi i hapësirave publike i bizneseve që kryesisht janë në pjesën që tani është më pak e rëndësishme sa qendrat e reja që janë bërë. Ne për ta favorizuar edhe shatërvanin edhe pjesën qendrore të të qytetit do duhej që bizneseve në këtë rast me iu ndihmu, është shumë e lart taksa e cila ju është vu për shfrytëzimin e hapësirave publike. Andaj, po propozoj kam propozim konkretë që nga 30 janë të zbritët në 15 kjo sepse besoj që është e mjaftueshme, sepse kanë hapësira të të mëdha edhe nuk mund ti shfrytëzojnë me kapacitet plot, sepse dihet që thash në fillim i ka ra i ka ra interesi i shatërvanit e qendrës qytetit sepse është bart qendra në pjesë tjera. Kam propozim konkretë nga 30 cent në 15 të zbritet e ky çmim, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): faleminderit, po Florenti fjalën.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit kryesuese, edhe unë pajtohem me Xenin. Se Nënkyetari pe cekë që ka klube që kanë edhe të ardhura tjera përveç subvencionimit. Por, janë diku edhe tre katër klube që nuk kanë të ardhura tjera përveç që subvencionohen nga komuna e Prizrenit, dhe të jeni të bindur, unë vetë e menaxhoj një klub, nuk ka mundësi me e dalë me ato subvencionime që i bën komuna, dmth nuk ka mundësi me ia dalë po mos të janë edhe disa biznese vullnet mirë që e përkrahin. Tash kur i shtohet edhe edhe këto shpenzime tjera, këtyne klubeve unë po besoj që 3-4 klube së paku ligën ku veprojmë ne, këtë vit do të shuhen. Edhe një pjesë e fajit ju bartet edhe juve që i keni rritur çmimet, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): faleminderit, po Petrit.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit Kryesuese. Unë zakonisht me Shkëlzenin nuk pajtohem kurrë, po këtë rast pajtohem edhe jam i mendimit që duhet me u rregullu kjo çështja ashtu siç e para edhe bisedoj pak më herët. Njashtu edhe propozimi i shefit grupit LDK-së Hazizit, është mirë që të ulet edhe taksa në atë çmim, faleminderit.

Kujtim Gashi (Nënkyetar i Komunës): Edhe njëherë. Sa i përket propozimeve të Hazizit, ato janë dhënë në emër të grupit prej Marinin atë ditë për një zbritje në përqindje...jo i kemi ikë te vlerat 1 euro që kanë qenë, se me i ulë ato 20% i bibe diku 80 cent.... Nëse mendoni që funksionon institucioni kështu!!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ishte edhe propozimi për klubet drejtor?

Adem Morina (Drejtor DKRS): Kryesuese kur kemi fillu domethënë iniciativën për plotësim ndryshim e kësaj rregullore, Xeni ka qenë edhe herën e parë kur është votuar domethënë me 30 qershor të vitit 2022, ka edhe disa muaj që kemi filluar me këtë rregullore me plotësuar. Mirëpo, duke e ditë Xeni deri tash të gjitha rekomandimet e secilit kuvendar dhe atyre që dhanë kontribut për me bë plotësim ndryshimin i kemi marr parasysh. Herën e fundit kur patëm takimin e fundit këtu në sallë, propozuan që të ulen çmimet edhe të stadiumeve, të sallave, jo sa ju keni propozu me u ulë çmimet, ne i kemi ulë akoma më tepër. Domethënë kemi shku edhe nja 50% më pak. Mirëpo, Xen po më vjen shumë keq sinqerisht sepse këtu janë shtjerrë të gjitha mundësitë, të ish qenë ky rekomandim më herët e kishim pasë parasysh. Por, me të gjitha këto pika jeni pajtuar të gjithë edhe nuk kemi mund me ditë në tash me pas hamendje a do të jetë dikush i pa kënaqur a jo!. Ju thashë kemi shku gati shumicën më tepër se 50% sa ju keni kërkuar u liru taksat! Te salla mundjes është fjala, qysh e përmendi edhe nënkryetari e dini aty është një kosto goxha madhe e mirëmbajtjes të sallës mundjes, ka kapacitete edhe ngrohja, edhe ftohja edhe ndriçimi edhe gjitha ato. Unë po besoj që një klub serioz ku ju e dini shumë mirë se aty nuk munden me ushtru shumë klube dhe kemi pasur probleme dhe defekte, një klub serioz nuk është çmimi i lartë 10 euro në ditë. Mirëpo, këto propozime dhe rekomandime është dasht Xen me ardhë më herët e jo tash ditën e fundit ku ne kemi shtjerrë të gjitha mundësitë dhe jemi dakordu me të gjithë juve këtu, që kjo të jetë epilogu përfundimtar, sinqerisht po ndihem keq!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Dikush tjetër? Domethënë nuk kemi mundësi më me i ndërru këto diçka a po drejtor?

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Kryesuese, këta kanë bërë propozime...Hazizi po bënë propozime, Xeni në moment të fundit po bënë... ka të drejt. Ne e kemi shtyrë këtë rregullore prej një seancë në këtë seancë për mu harmonizu, tash vetëm palestra e sporteve shpenzon në ditë për nxemje 500 euro, edhe duhet me bë mend qysh ata i paguajnë shpenzimet.

Shkëlzen Kastrati (PDK): Po rritjani çmimin qendrës sportive masi po i harxhon 500 euro në ditë ngrohja. Salla mundjes janë tre katër klube menxi e mbajnë vetveten. Unë e njoh këtë sport! Po jo po nuk është e jona na me thënë le të shuhen sporti, na po dojmë me ngrit sportin, jemi tu deshë me ndihmu dhe me ngrit sportin. 20 euro dita stërvitja është shumë, nuk mujnë veç mu mshelë krejt!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Mirë faleminderit. Atëherë kështu propozimet i morëm ky 30 centëshi të kalojë në 15 dhe puna e sallave. Po e hedhim bashkë me propozim këtë rregullore në votim. Kush është për miratohet, prezent jemi... me propozimet që u dhanë, propozimet që dhanë..

Shkëlzen Kastrati (PDK): Unë thashë, te salla mundjes vetëm në mënyrë simbolike me lënë 1 euro orën, ashtu kështu ajo sallë ka funksionuar qe 7-8 vjet pa asni cent. Kërkush s'ka paguar kurrë për atë sallë, kërkush asnjë cent se ka paguar!... Jo mundesh mundesh me lanë, kushdo që e shfrytëzon 1-2 euro në mënyrë simbolike edhe kjo tregon që na dona me ju ndihmu atyne dhe jo me i ndëshku ata. Propozimi im është 1 euro me bë për orë!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Shkojmë me propozimin që u bënë nga zoti Hodaj. Kush është për që të miratohet ky propozim prezent jemi 22. Kush është për? 20 për. Kundër? 0 kundër. Abstenim? 0 abstenim. Atëherë propozimin që e dha Shkëlzeni po e hedhim në votim. Prezent jemi 22 anëtarë. Kush është për?

Qemal Krasniqi (LDK): Xen të gjithë ishim një mendimit, po këtu s'po pajtohemi një euro shumë.... Mos ta qesim në votim po të merremi vesh.

Levent Bus (KDT): Xen 5 euro a po bëjmë.

Shkëlzen Kastrati (PDK): Nëse ka mundësi veç edhe një sqarim. Sa kemi informatë klubet e mundjes që i kanë nxënëst e vet nuk ju marrin pagesë, nuk është nuk është i njëjti futbollit shkollat e futbollit që marrin pagesë nga 10 euro për person. Këta do të thotë i kanë stërvitjet në mënyrë vullnet mirë, asnjë pagesë nuk e merr asnjë klub për një nxënëst. Prandaj po them është shumë e shtrejt, ne mundemi me e bë edhe 20-30 euro.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): Mirë tash aty atë 1 euroshin është mirë me bë zero euro, po me atë kushtin që drejtori duhet me pas parasysh që këto klube që favorizohen në këtë mënyrë pa pagesë në shfrytëzim sallave nuk përfitojnë prej subvencioneve!

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Mirë atëherë i dhanë propozimet propozimin e Xenit të hedhim në votim prej 1 euro, prezent jemi 22 kush është për 1 euro ? ju lutem dorën për 1 euro kush e ka për ju lutem për propozimin prej 1 eurove? 10 jemi për. Kush është kundër? kush është kundër? Ngriteni dorën ju lutem kush është kundra... 5 kundër. Atëherë s'kemi kuorum. Prezent jemi 20 kështu që neve na duhet këtu me e ndërpre mbledhjen edhe nuk mund ta vazhdojmë me procesin e votimit. Seanca mbyllet këtu. Të nderuar anëtarë të kuvendit, duke ju falënderuar secilin prej juve që keni dhënë kontribut në vitin 2023. Uroj që në vitin 2024 të keni shëndet e begati në familjet e juaja dhe gëzuar vitin 2024.

Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi
Bytyqi

